

ALBERTO MORAVIA
KONFORMISTI
ROMAN

BOTIMET TOENA

Alberto Moravia

Konformisti

Roman

Përkthet nga origjinali italisht:
Prof. dr. Klara Kodra

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2015

Autori: Alberto Moravia
Titulli në original: Il Conformista
Botuar në italisht nga: Bompiani

Questo libro è stato tradotto grazie ad un contributo alla traduzione assegnato dal Ministero degli Affari Esteri Italiano.

Ky libër u përkthye falë kontributit për përkthim të akorduar nga Ministria e Punëve të Jashtme Italiane.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Arlinda Rrushi
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Albana Gega

ISBN 978-9928-205-08-7

© Bompiani / RCS Libri. S.p.A., Milan, 1983-2014
© *në shqip* Botimet Toena, 2015

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PROLOG

I

Në kohën e fëmijërisë së tij, Marçelon e joshnin sendet sikur të ishte laraskë. Kjo ndodhte ngaqë në shtëpi, më tepër për indiferentizëm sesa për rreptësi, prindërit s'kishin menduar fare t'ia kënaqnin instinktin e pronës; apo ngase instinkte të tjera më të thella dhe ende të errëta, tek ai maskoheshin si lakmi; në fakt, atë e kapnin vazhdimisht dëshira të furishme për sendet më të ndryshme. Një laps me majë prej gome, një libër me figura, një llastik, një vizore, një shishe boje portative prej ebaniti, çdo gjë e vogël e çonte shpirtin e tij më parë në një dëshirë të fuqishme dhe të paarsyeshme për gjënë e lakmuar dhe më pas, si ta kishte shtënë në dorë, në një kënaqësi të çuditshme, të magjishme, të pangopur. Marçeloja kishte në shtëpi një dhomë të tërën për vete ku flinte apo studionte. Aty, gjithë sendet e shpërndara mbi tavolinë apo të mbyllura në sirtarë,

kishin për të natyrën e gjërave ende të shenjta apo të çshenjtëruara në varësi nga fakti nëse blerja e tyre ishte bërë herët apo vonë në kohë. Pra, ato nuk ishin sende të ngjashme me sendet e tjera që ndodheshin në shtëpi, por copëza të një përvoje që duhet të përjetohej apo tashmë ishte përjetuar, një ngarkesë me pasion dhe fshehtësi. Marçeloja ishte i vetëdijshëm në mënyrën e tij për atë tipar të veçantë që kishte pronësia dhe, ndërsa ndiente prej saj një kënaqësi të papërshtueshme, ndiente për këtë shkak, njëkohësisht, edhe vuajtje si për një faj që përsëritej vazhdimisht dhe që nuk linte as kohë të pendoheshe.

Megjithatë, midis të gjitha atyre sendeve, ato që e tërhiqnin më shumë ishin armët, mbase ngaqë ishin të ndaluara. Jo, aspak armët e rreme me të cilat luajnë fëmijët, pushkët prej llamarine, revolet me kapsolle, kamat prej druri, por armët e vërteta të cilat ideja e kërcënimit, rrezikut dhe vdekjes nuk i besohet një ngjashmërie të thjeshtë formash, por është arsyeja e parë dhe e fundit e ekzistencës së tyre. Me revolet për fëmijë luhej me vdekjen pa pasur asnjë mundësi për ta shkaktuar vërtet, por me revolet e të rriturve, vdekja jo vetëm ishte e mundshme, por kërcënuese si një tundim që e frenonte vetëm maturaia. Marçeloja kishte pasur, nganjëherë nëpër duar armë të tilla të vërteta, si një pushkë gjahu në fshat, revolen e vjetër të të atit, që ky i fundit i kishte treguar një ditë në një sirtar, dhe çdo herë kishte ndier një dridhmë komunikimi ashtu sikur dora e tij të kishte gjetur një zgjatje të natyrshme në dorezën e armës.

Marçeloja kishte shumë miq midis fëmijëve të lagjes dhe shumë shpejt e kishte kuptuar se tërheqja e tij ndaj armëve kishte një origjinë më të thellë e më të errët se pasionet e tyre të pafajshme luftarake. Ata luanin ushtarësh duke u shtirur si të pamëshirshëm dhe të egër, po duke synuar në të vërtetë lojën për hir të lojës dhe duke imituar si majmunë ato qëndrime mizore pa një përfshirje të vërtetë; kurse tek ai ndodhte e kundërta: ishin zemërgurësia dhe egërsia që kërkonin të shfryheshin në lojën e ushtarëve dhe, në mungesë të lojës, në dëfrime të tjera të përshtatura me shijen e shkatërrimit dhe të vdekjes. Në atë kohë Marçeloja ishte mizor, pa brerje ndërgjegjeje dhe pa turp, në mënyrë krejt të natyrshme, sepse nga mizoria i vinin të vetmet kënaqësi që nuk i dukeshin të shpëlara dhe ajo mizori ishte ende mjaft fëmijërore, aq sa të mos zgjonte dyshime as tek ai vetë dhe as te të tjerët. Për shembull, në atë fillim vere, i ndodhte të zbriste në kopsht, në një orë të nxehtë. Ishte një kopsht i ngushtë, por me bimësi të dendur ku, në mes të çrregullimit të madh, rriteshin bimë dhe pemë të braktisura prej vitesh në harlisjen e vet të natyrshme. Marçeloja zbriste në kopsht i armatosur me një xunkth të hollë dhe të përkulshëm, që e kishte shkukur nga një rrahëse e vjetër qilimash në papafingo; dhe endej për pak në mes të hijeve lozonjare të pemëve dhe rrezeve të përvëlura të diellit, nëpër rruginat me gurë, duke vështuar bimët. E ndiente se sytë i ndrinin, se tërë trupi i çelej nga një ndjesi mirëqenieje që dukej sikur shkrihej me gjallërinë e përgjithshme të kopshtit të harlisur dhe plot dritë, dhe e ndiente veten të lumtur.

Por me një lumturi agresive dhe mizore, thuajse sikur donte të matej me fatkeqësinë e të tjerëve. Sa shikonte në mes të një lehe një tufë të bukur margaritash me lule të bardha e të verdha apo një tulipan me kurorën e kuqe që rrinte mbi kërcellin e gjelbër apo një bimë të egër me lulet e gjata të bardha dhe mishtore, Marçeloja e lëshonte xunkthin me një goditje të vetme duke e bërë të fishkëllente në ajër si shpatë. Xunkthi priste në çast lule dhe gjethe që binin dëlirësisht në tokë pranë bimës, duke i lënë në këmbë kërcëjtë kryeprerë. Duke bërë kështu, përjetonte një dyfishim të gjallërisë dhe gati-gati kënaqësinë shumë të këndshme që të jep shfrimi i një energjie të shtypur gjatë; por njëkohësisht një ndjenjë të papërcaktuar pushteti dhe drejtësie. Tamam sikur ato bimë të kishin qenë fajtoreshë dhe ai t'i kishte dënuar dhe njëkohësisht të kishte ndier që dënimi ishte në dorë të tij. Por fakti që ky lloj argëtimi ishte i ndaluar dhe i fajshëm s'ishte fare i panjohur për të. Herë pas here, si pa dashur, ai i hidhte vështrime tinëzare vilës, duke pasur frikë se mos e ëma nga dritarja e sallorit apo gjellëbërësja nga dritarja e kuzhinës mund ta shihnin. Dhe e kuptonte se nuk i trembej aq ndonjë qortimi të mundshëm, sa dëshmisë së thjeshtë të disa veprimeve që ai vetë e ndiente se ishin anormale dhe si të ngjyrosura në mënyrë enigmatike me faj.

Kalimi nga lulet e bimët te kafshët që gati i pandjeshëm, siç ndodh në natyrë. Vetë Marçeloja s'do të mund të thoshte asgjë kur vuri re se po ajo kënaqësi që ndiente duke shkukur bimët dhe duke ua prerë kryet luleve i shfaqej më e fuqishme dhe e thellë kur e përdorte

po atë dhunë kundër kafshëve. Mbase qe rastësia që e shtyu në këtë rrugë, një goditje xunkthi që, në vend të të godiste një shkurrëz, goditi në shpinë një hardhucë të përgjumur mbi degë apo ndoshta një fillim mërzie dhe ngopjeje që i sugjeroi të kërkonte një lëndë të re ku ta ushtronte mizorinë e vet ende të pandërgjegjshme. Sidoqoftë, një pasdite të heshtur, kur të gjithë në shtëpi po flinin, Marçeloja u gjend papritur si i goditur nga një rrufe pendimi dhe turpi, përballë një masakre hardhucash. Ishin pesë a gjashtë hardhuca që ai i kishte zbuluar në mënyra të ndryshme mbi degët e pemëve apo gurët e murit rrethues, duke i lënë në vend me një goditje të vetme xunkthi tamam në çastin kur ato, të shtëna në dyshim nga prania e tij e palëvizur, po përpiqeshin t'ia mbathnin drejt ndonjë strehe. Sesi arriti në këtë pikë, ai s'e thoshte dot, apo më mirë të thuash, parapëlqente të mos e kujtonte, po tani gjithçka kishte marrë fund dhe s'mbetej asgjë veç diellit të zjarrtë dhe të pistë mbi trupat e përgjakur dhe të njollosur me pluhur të hardhucave të ngordhura. Ai rrinte në këmbë para trotuarit prej çimentoje ku dergjeshin hardhucat, me xunkthin të shtrënguar në grusht dhe duke ndier ende nëpër trup e fytyrë eksitim që e kishte pushtuar gjatë masakrës, por jo ëmbëlsisht të vrullshëm, si më parë, po të çngjyrosur nga pendimi e turpi. Ishte ndërgjegjësuar, gjithashtu, që ndjenjës së mëparshme të mizorisë dhe pushtetit i ishte shtuar kësaj radhe një turbullim i veçantë, i paprovuar më parë, në mënyrë të pashpjegueshme fizike; dhe bashkë me turpin dhe pendimin, përjetonte një ndjesi të turbullt paniku. Njësoj sikur të kishte zbuluar në vetvete

një tipar krejt anormal, për të cilin duhet t'i vinte turp dhe që duhet ta mbante të fshehtë për të mos ndier turp jo vetëm para vetes, po edhe para të tjerëve, tipar që si rrjedhim do ta ndante përgjithmonë nga shoqëria e bashkëmoshatarëve.

S'kishte dyshim, ai ndryshonte nga djemtë e vegjël moshatarë që nuk merreshin as vetëm, as me shokë me dëfrime të tilla dhe, për më tepër, ai ndryshonte prej tyre në një mënyrë të dukshme. Që hardhucat kishin ngordhur, për atë s'kishte dyshim, se vdekja e tyre dhe veprimet e kryera prej tij, mizore dhe të çmendura për ta shkaktuar, ishin të pandreqshme. Pra, ai identifikohet me ato veprime siç ishte identifikuar në të kaluarën me veprime të tjera krejt të pafajshme dhe normale.

Atë ditë, për ta vërtetuar këtë zbulim aq të ri dhe aq të dhimbshëm të anormalitetit të vet, Marçeloja deshi të përballej me një mikun e vet të vogël, Robertin, që banonte në vilën pranë tij. Në muzg Roberti, pasi mbaronte së studiuar, zbriste në kopsht dhe deri në orën e darkës, me pëlqimin e heshtur të dy familjeve, dy djemtë luanin së bashku, herë në kopshtin e njërit, herë në atë të tjetrit.

Marçeloja e priti me padurim atë çast, për tërë pasditen e heshtur e të gjatë, i vetmuar në dhomën e vet, i shtrirë në krevat. Prindërit e tij kishin dalë, në shtëpi ishte vetëm gjellëbërësja, zërin e së cilës ai e dëgjonte tek këndonte zëulët në kuzhinë, në katin përdhes. Ai, zakonisht, pasditeve, studionte apo luante vetëm në dhomë, por atë ditë nuk po e tërhiqnin as studimi, as loja; e ndiente veten të pazot të bënte çfarëdo gjëje dhe

njëkohësisht s'duronte dot limontinë; tronditja e zbulimit që i dukej se kishte bërë dhe shpresa që kjo tronditje do të kalonte pas takimit të afërt me Robertin e paralizonin dhe, njëkohësisht, e bënin të paduruar. Po qe se Roberti do t'i thoshte se edhe ai i vriste hardhucat dhe i pëlqente t'i vriste, pa parë asgjë të keqe në këtë, do t'i dukej se do të treqej çdo ndjesi anormaliteti tek ai dhe vetë ai do ta shihte masakrën e hardhucave si një ndodhi pa kuptim dhe pa pasojë. S'e dinte se pse i atribuonte Robertit një autoritet të tillë; në një mënyrë të errët, mendonte që, nëse edhe Roberti i bënte po ato gjëra, në po atë mënyrë dhe me po ato ndjenja, kjo donte të thoshte se ishin gjëra që i bënin të gjithë dhe, përderisa e bënin të gjithë, ishte normale, pra, e mirë. Këto mendime, nga ana tjetër, s'ishin aq të qarta në mendjen e Marçelos dhe i shfaqeshin më tepër si ndjenja dhe nxitje të thella sesa si mendime të përcaktuara. Po i dukej se ishte i sigurt kryesisht për një fakt: nga përgjigjja e Robertit varej qetësia e shpirtit të tij.

Me atë shpresë dhe me atë tronditje priti me padurim orën e muzgut. Për pak do ta zinte gjumi, kur i erdhi nga kopshti një fishkëllimë e gjatë e modular: ishte sinjali i zakonshëm me të cilin Roberti e lajmëronte për praninë e vet. Marçeloja u ngrit nga krevati dhe, pa i ndezur dritat, në gjysmerrësirën e perëndimit, doli nga dhoma, zbriti shkallët dhe nxori kokën në kopsht.

Në dritën e zbehtë të muzgut veror pemët rrinin të palëvizura dhe të zymta; nën degë hijë ngjante tashmë si natë. Aroma e luleve, era e pluhurit, rrezatimet diellore

që buronin nga toka e nxehur qëndronin të amullta në ajrin e palëvizur dhe të dendur. Kangjellat që ndanin kopshtin e Marçelos nga ai i Robertit ishin krejt të mbuluara nga një dredhëz vigane e dendur dhe e thellë, që dukej si një mur i ndërtuar me gjethe. Marçeloja shkoi tamam drejt një qosheje në fund të kopshtit ku dredhëza dhe hija ishin më të dendura, hipi në këmbë mbi një gur të madh dhe vetëm me një gjest të vendosur largoi një masë të tërë bime kacavjerrëse.

Kishte qenë ai vetë që kishte shpikur atë lloj sporteli midis gjetheve të dredhëzës, për një ndjenjë loje të fshehtë dhe që lidhej me aventurën. Sa u zhvendos dredhëza, u dukën prapa saj shufrat e hekurta të kangjellave dhe, midis këtyre shufrave, fytyra fine dhe e zbehtë, nën flokët biondë, të mikut të tij, Robertit. Marçeloja u ngrit në majë të këmbëve mbi gur dhe pyeti:

- A na pa njeri?

Ishte formula fillestare e kësaj loje. Roberti u përgjigj si duke recituar një mësim:

- Jo, asnjeri... Dhe mandej, pas një çasti pyeti: - A studiove ti?

Fliste duke pëshpëritur, një veprim tjetër për të cilin ishin marrë vesh. Duke pëshpëritur edhe ai, Marçeloja u përgjigj:

- Jo, sot s'kam studiuar... s'kisha qejf... Do t'i them mësueses se isha keq.

- Unë e shkrova detyrën e italishtes, - murmuriti Roberti, - dhe bëra edhe një nga detyrat e aritmetikës, më mbetet edhe një... Po ti, pse nuk mësove?

Kjo ishte pyetja që priste Marçeloja.

- S'kam mësuar, - u përgjigj ai, - se gjuajta hardhuca. Shpresonte që Roberti t'i thoshte: "Ah, vërtet... Edhe unë gjuaj në ndonjë rast". Por fytyra e Robertit nuk shprehte asnjë bashkëfajësi dhe as kureshtje. Pastaj, duke u munduar të fshihte sikletin e vet, shtoi me mundim:

- I vrava të gjitha.

Roberti e pyeti me maturi:

- Sa?

- Shtatë gjithsej, - u përgjigj Marçeloja. Dhe më vonë, duke e shtrënguar veten për një vetëmburrje teknike dhe informuese, tha: - Rrinin mbi degët e pemëve dhe mbi gurë... Unë prita që të lëviznin e mandej i kapa fluturim... Me një goditje të vetme të këtij xunkthi... një goditje secila. Bëri një ngërdheshje kënaqësie dhe ia tregoi xunkthin Robertit.

T'jetri e pa me një kureshtje të pashkëputur nga njëfarë habie:

- Pse i vrave?

- Kështu, - ai ngurroi, për pak do të thoshte: "Se më pëlqente", mandej s'e dinte as ai pse, por e përmbajti veten dhe u përgjigj: - Se janë të dëmshme... A s'e di që hardhucat janë të dëmshme?

- Jo, - tha Roberti, - s'e dija... Pse janë të dëmshme?

- Hanë rrushin, - u përgjigj Marçeloja, - parvjet në fshat e hëngrën tërë rrushin e pjergullës.

- Po këtu s'ka rrush.

- Pastaj, - vazhdoi ai, pa u kujdesur ta vinte re kundërshtimin, - janë të këqija... njëra prej tyre, sa më pa, në vend që të ikte, m'u turr gojëhapur... Po të mos e kisha

ndaluar në kohë, do të më hidhej përsipër... Ai heshti për një çast, mandej, duke treguar më shumë familjaritet, shtoi:

- Ti vetë s'ke vrrarë kurrë.

Roberti tundi kokën dhe iu përgjigj:

- Jo, kurrë.

Pastaj, duke ulur sytë, me një shprehje të pikëlluar, tha:

- Thonë se s'duhet t'u bësh keq kafshëve.

- Kush e thotë?

- Mami.

- Sa gjëra thuhën... - tha Marçeloja, gjithnjë e më pak i sigurt në vetvete, - po ti provoje, budalla... të siguroj se është diçka e këndshme.

- Jo, s'do ta provoj.

- E pse?

- Se është keq.

“Pra, s'mund të bëhej asgjë”, mendoi Marçeloja me inat. Ndjeu një vrull zemërimi kundër shokut që, pa e kuptuar, e gozhdonte pas anormalitetit të vet. Megjithatë e mbajti veten dhe i propozoi:

- Shiko, nesër do të gjuaj prapë hardhuca, po të vish edhe ti që të gjuash bashkë me mua, do të ta fal atë palën e letrave të “Tregtarit të Panairit”*.

E dinte se ai premtim do ta tundonte Robertin; kushedi sa herë ai kishte shprehur dëshirën ta kishte atë palë letrash. Dhe, në fakt, Roberti, si pushtuar nga një frymëzim i papritur, u përgjigj:

* Lojë me letra (shën. i përkth.).

- Unë po vij që të gjuaj, por me një kusht: që t'i zëmë të gjalla dhe mandej t'i mbyllim në një kuti e pastaj t'i lëmë të lira... dhe ti do të ma japësh atë palë letrash.

- Këtë jo, - tha Marçeloja, - e bukura qëndron tamam në atë që t'i godasësh me këtë xunkth... Vë bast që s'je i zoti.

Roberti s'tha asgjë. Marçeloja vazhdoi:

- Hajde, atëherë... u morëm vesh... Po kërko një xunkth edhe për vete.

- Jo, - tha Roberti me kokëfortësi, - s'do të vij.

- Po pse? Ato letra janë të reja.

- Jo, është e kotë, - tha Roberti, - unë hardhucat nuk i vras... edhe sikur. Ai ngurroi duke kërkuar një send të ngjashëm. - As po të ma japësh revolen tënde.

Marçeloja e kuptoi se s'do të arrinte asgjë dhe, papritur, iu dorëzua zemërimin që prej pak minutash i ziente në kraharor.

- Ti nuk do se je frikacak, - tha, - se ke frikë.

- Po frikë nga se? Po më bën tamam të qesh.

- Ke frikë, - përsëriti Marçeloja i nxehur, - se je një lepur... një lepur i vërtetë. Papritur zgjati një dorë midis hekurave të kangjellave dhe e kapi shokun për veshi.

Roberti i kishte veshët e kërcyer dhe të kuq, dhe s'ishte hera e parë që Marçeloja ia kapte, por kurrë me aq zemërim dhe me një dëshirë aq të qartë për ta lënduar.

- Prano se je një lepur.

- Jo, lërmë, - filloi të ankohej Roberti duke u përpëlitur, - ah, ah!

- Prano se je lepur.

- Jo... lërmë.

- Prano se je lepur.

Në dorën e tij veshi i Robertit digjej i nxehtë dhe i djersitur; ca lot u dukën në sytë e kaltër të djalit të munduar.

- Po, mirë, - belbëzoi ai, - jam lepur, - dhe menjëherë Marçeloja e la. Roberti kërceu poshtë kangjellave dhe duke vrapuar thirri: - S'jam lepur... Kur po e thosha, mendova: "S'jam lepur... ta hodha". U zhduk dhe zëri i tij, i përlotur dhe tallës, humbi larg, përtej pyjeve në miniaturë të kopshtit fqinj.

Nga ky dialog atij i mbeti një ndjenjë pafuqie e thellë.

Roberti i kishte mohuar, bashkë me solidaritetin e vet, faljen që ai kërkonte dhe që i dukej e lidhur me atë solidaritet. Kështu, ai ishte rikthyer prapa në anormalitet, por jo pa ia treguar në fillim Robertit, siç ishte krejt i vetëdijshëm, sa shumë donte të dilte prej tij, pa iu dorëzuar gënjeshtres dhe dhunës.

Tani turpit dhe pendimit për vrasjen e hardhucave i shtohet turpi dhe pendimi se e kishte gënjyer Robertin për arsyet që e shtynin t'i kërkonte bashkëfajësi dhe se e kishte tradhtuar veten në atë çast zemërimi kur e kishte kapur nga veshi.

Fajit të parë i shtohet një faj i dytë dhe ai s'mund të çlirohej në asnjë mënyrë, as nga njëri, as nga tjetri.

Ndërkaq, në mes të këtyre meditimeve të hidhura, ai i kthehej me kujtesën e vet masakrës së hardhucave, gati duke shpresuar se kujtimi i saj do t'i vinte i çliruar nga çdo pendim, një fakt si të gjithë të tjerët. Por menjëherë vinte re se do të kishte dashur që hardhucat të mos kishin ngordhur kurrë; dhe ndërkaq po i kthehej, e gjallë dhe mbase jo aq e pakëndshme, po pikërisht për këtë, aq më

shumë e neveritshme, ajo ndjesi eksitimi dhe turbullimi fizik që kishte përjetuar ndërsa po i gjuante; me aq forcë sa i zgjonte dyshimin se ditët e ardhshme s'do t'i qëndronte dot tundimit për ta përsëritur masakrën. Ky mendim e trembi: pra, ai jo vetëm ishte anormal, por në vend që ta zhdukte këtë anormalitet ai as e kontrollonte dot. Në atë çast ishte në dhomën e vet, i ulur në tavolinë, para një libri të hapur, duke pritur darkën. Papritur u ngrit, u drejtua nga krevati dhe duke u gjunjësuar te qilimi pranë krevatit, siç e kishte zakon të bënte kur recitonte lutjet, tha me zë të lartë, duke bashkuar duart, me një ton që iu duk i sinqertë:

- Beto hem para Zotit që s'do t'i prek më as lulet, as bimët, as hardhucat.

Megjithatë, nevoja për falje, që e kishte shtyrë të kërkonte bashkëfajësinë e Robertit, vazhdonte të ndihej, e shndërruar tashmë në të kundërtën e vet, në një nevojë për dënim. Roberti, që do të mund ta shpëtonte nga brerja e ndërgjegjes duke i qëndruar pranë, s'kishte autoritet të mjaftueshëm për të vërtetuar drejtësinë e asaj brerjeje të ndërgjegjes dhe të vinte rregull në kaosin e mendjes së tij me një vendim të paapelueshëm. Ishte një fëmijë si ai, i pranueshëm si bashkëfajtor, por i papërshtatshëm si gjykatës. Veçse Roberti, duke mos e pranuar propozimin e tij, kishte përmendur si mbështetje për neverinë e vet, autoritetin e së ëmës. Marçeloja mendoi t'i drejtohej edhe ai nënës së vet. Vetëm ajo do të mund ta dënonte a ta falte dhe, sidoqoftë, ta përfshinte veprimin e tij në një rend të çfarëdoshëm. Marçeloja, që e njihnte të ëmën, arsyetonte

në mënyrë abstrakte, si duke iu referuar një nëne ideale, ashtu si duhet të ishte ajo dhe në të vërtetë nuk ishte. Në fakt, ai dyshonte se do të nxirrte ndonjë rezultat duke iu drejtuar asaj. Por, sidoqoftë, ai s'kishte nënë tjetër dhe, nga ana tjetër, nxitja e tij për t'iu drejtuar asaj ishte më e fortë se çdo dyshim.

Marçeloja priti çastin në të cilin e ëma, pasi ai kishte rënë të flinte, vinte në dhomë t'i thoshte “natën e mirë”. Ky ishte njëri nga çastet kur ai mund të ishte vetëm me të; në më të shumtën e rasteve, në vaktet e ngrënies apo në shëtitjet e rralla me prindërit, i ati ishte gjithnjë i pranishëm. Marçeloja, ndonëse instinktivisht s'kishte shumë besim tek e ëma, e donte dhe, mbase, më shumë se ta donte, e admironte në një mënyrë të pasigurt dhe të përkushtuar, ashtu si admirohet një motër e madhe me zakone të çuditshme dhe me një karakter tekanjuz. E ëma e Marçelos, që ishte martuar fare e re, kishte qëndruar moralisht dhe gjithashtu fizikisht një vajzë e re; nga ana tjetër, ndonëse s'kishte pothuajse fare afrimitet me të birin, me të cilin merrej fare pak për shkak të angazhimeve të shumta mondane, ajo s'e kishte ndarë asnjëherë jetën e vet nga e tija.

Kështu, Marçeloja ishte rritur në një pështjellim të vazhdueshëm me hyrje dhe dalje të furishme, me rroba të veshura dhe të flakura, me biseda të pafundme dhe pa kripë në telefon, me teka ndaj rrobaqepësve dhe furnizuesve, me grindje me kamerieren, me ndryshime të vazhdueshme humori për shkaqe nga më të papërfillshme. Marçeloja, kureshtar dhe i lënë pas dore, mund të futej në dhomën e së ëmës në çfarëdo momenti,

si spektator i një intimiteti ku ai vetë nuk zinte asnjë vend. Nganjëherë e ëma, si duke u shkundur nga plogështia prej një pendimi të papritur, vendoste t'i kushtojë të birit dhe e merrte me vete te ndonjë rrobaqepëse apo modiste kapelash. Në këto raste, i shtrënguar siç ishte të kalonte orë të gjata, i ulur në një fron, ndërsa e ëma provonte kapela dhe rroba, Marçeloja pothuaj qante me lot mospërfilljen e stuhishme të zakonshme të së ëmës.

Atë mbrëmje, siç e kuptoi menjëherë, e ëma nxitonte më shumë se zakonisht dhe, në fakt, para se Marçeloja ta kishte gjetur kohën për ta kapërcyer ndrojtjen e vet, ajo i ktheu krahët, duke iu drejtuar nëpërmjet dhomës së errët, derës së mbetur gjysmë të hapur. Po Marçeloja s'kishte ndër mend ta priste edhe një ditë atë gjykimin që i nevojitej. Duke u ngritur ulur mbi krevat, ai thirri me zë të lartë:

- Mama.

E pa ta kthente kokën nga prapa me një gjest gati të bezdisur.

- Ç'është, Marçelo? - pyeti ajo duke iu afruar krevatit.

Tani qëndronte në këmbë pranë tij, në anën e kundërt të dritës, e bardhë dhe e hollë në rrobën e zezë dekolte. Fytyra fine dhe e zbehtë, e rrethuar nga flokët e zinj, ishte në hije, po jo aq shumë sa Marçeloja të mos dallonte aty një shprehje të pakënaqur, të nxituar dhe të paduruar.

Megjithatë, i shtyrë nga nxitja e tij e brendshme, ai e paralajmëroi:

- Mama, duhet të të them diçka.

- Mirë, Marçelo, po nxito... mami duhet të ikë... babi po pret... Ndërkaq, me të dyja duart te zverku, ajo

rropatej për të mbërthyer kapësen e gjerdanit. Marçeloja donte t'i tregonte së ëmës masakrën e hardhucave dhe ta pyeste a kishte vepruar keq. Po nxitimi i së ëmës e bëri të ndërronte mendje. Më saktë, ta ndryshonte frazën që kishte përgatitur në mendje.

Hardhucat i ngjanë si kafshë tepër të vogla e të parëndësishme për të tërhequr vëmendjen e një njeriu aq të hutuar. Aty për aty, as vetë s'e dinte pse shpiku një gënjeshtër për ta zmadhuar krimin e vet. Shpresonte që me madhësinë e fajit ta prekte ndjeshmërinë e së ëmës që, në mënyrë të errët, e përfytyronte si të topitur dhe të plogët.

- Mami, - tha me një siguri që e çuditi, - e vrava macen.

Në atë çast e ëma kishte arritur t'i bënte të përputheshin dy pjesët e kapëses. Me duart e bashkuara mbi zverk, mjekrën e gozhduar mbi gjoks, ajo shikonte në tokë dhe, herë pas here, nga padurimi, përplaste takën në dysheme.

- Ah, po, - tha me një zë pa shprehje, si e zbrazur nga çdo vëmendje nga sforcimi që po bënte. Marçeloja theksoi i pasigurt:

- E vrava me llastik.

E pa të ëmën të tundte kokën me inat dhe mandej t'i hiqte duart nga zverku, duke mbajtur me njëren dorë gjerdanin që s'kishte arritur ta mbyllte.

- Kjo kapëse e mallkuar, - shqiptoi ajo me zemërim. - Marçelo... bëhu djalë i mirë... më ndihmo ta vë gjerdanin. Ajo u ul mbi krevat, shtrembër duke ia kthyer krahët të birrit dhe shtoi me padurim: - Po kije mendjen që kapësja të mbyllet me zhurmë... përndryshe do të hapet prapë.

Ndërsa ishte duke folur, kishte kthyer nga ai supet e holla, të lakuriqta deri në vithe, të bardha si letër nën dritën

që vinte nga dera. Duart e holla me thonjtë e mprehtë dhe të kuq flakë e mbanin gjerdanin të varur mbi zverkun delikat që i bënin hije qimet kaçurrela. Marçeloja i tha vetes se, pasi të mbërthehej gjerdani, ajo do ta dëgjonte me më shumë durim; duke zgjatur trupin mori dy anët e kundërta të varësës dhe i mbërtheu menjëherë. Pastaj e ëma u ngrit menjëherë në këmbë dhe, duke u përkulur për t'ia prekur lehtë fytyrën me një puthje, tha:

- Faleminderit... tani fli... natën e mirë. Para se Marçeloja të mund ta përmbante me një gjest a me një thirrje, ajo qe zhdukur.

Të nesërmen koha ishte e ngrohtë dhe me re. Marçeloja, pasi kishte ngrënë në heshtje midis të dy prindërve gjithashtu të heshtur, rrëshqiti fshehurazi nga karrigia dhe përmes derë-dritares doli në kopsht. Si zakonisht, tretja i shkaktonte një gjendje fizike të keqe të turbullt ku përzihej fryrja dhe një tendencë reflektimi i saj.

Duke ecur dalëngadalë, gati në majë të gishtërinjve, mbi zallin që kërciste, në hijen e pemëve që ziente nga insektet, shkoi deri te kangjellat dhe vështroi jashtë. Iu shfaq rruga aq e njohur, disi e pjerrët, që kishte përreth dy radhë me pemë piperi, me një ngjyrë të gjelbër si të mbuluar me pupla dhe si qumështore, në atë kohë e zbrazët dhe çuditërisht e errët për shkak të reve të ulëta dhe të zeza që zinin qiellin. Përballë dukeshin kangjella të tjera, kopshte të tjera, vila të tjera të ngjashme me të tijën. Pasi e kishte vëzhguar me kujdes rrugën, Marçeloja u shkëput nga kangjellat, nxori nga xhepi llastikun dhe u përkul nga toka.

Në mes të zallit të imët kishte ca gurë të bardhë më të mëdhenj. Marçeloja mori një prej tyre me madhësinë

e arrës, e futi në diskun prej lëkure të llastikut dhe nisi të shëtiste gjatë murit që ndante kopshtin e tij nga ai i Robertit. Ideja e tij, apo më mirë ndjenja e tij ishte se ai ndodhej në gjendje lufte me Robertin dhe duhej të vëzhgonte me vëmendjen më të madhe dredhëzën që mbulonte murin rrethor dhe në lëvizjen më të vogël të shtinte, domethënë, ta hidhte gurin që shtrëngonte në llastik. Ishte një lodër në të cilën ai shprehte njëkohësisht inatin kundër Robertit që s'kishte pranuar të bëhej bashkëfajtor me të në masakrën e hardhucave dhe instinktin e egër dhe mizor që e kishte shtyrë në atë masakër. Natyrisht, Marçeloja e dinte shumë mirë që Roberti, i cili e kishte zakon që të flinte në atë orë, nuk e përgjonte prapa gjetheve të dredhëzës; dhe, megjithatë, ndonëse e dinte, vepronte me seriozitet dhe koherencë, sikur të ishte i sigurt që, përkundrazi, Roberti ishte aty. Dredhëza e vjetër dhe vigane ngjitej deri në majat e kunjave të kangjellave dhe gjethet e saj që mbulonin njëra-tjetrën, të mëdha, të zeza, të pluhurosura si dantella në një gjoks të qetë gruaje, rrinin të palëvizura dhe të flashkëta në ajrin e rënduar dhe pa asnjë flad ere. Nja dy herë u duk që një dridhmë fare e lehtë i bënte gjethet të lëviznin apo, më mirë, ia mbushi mendjen vetes se e kishte parë atë dridhmë dhe, menjëherë, me një kënaqësi të thellë, e hodhi gurin në mes të gjetheve të dredhëzës.

Menjëherë pas goditjes u përkul nxitimthi, mori një gur tjetër dhe mori prapë një pozicion lufte, me këmbët e hapura, krahët e shtrira përpara, llastikun gati për të gjuajtur: s'dihej, Roberti mund të ishte prapa gjetheve

duke marrë shenjë në drejtim të tij, me përparësinë se ishte fshehur, ndërsa ai, përkundrazi, ishte krejt i zbuluar. Kështu, gjatë asaj loje, arriti në fund të kopshtit aty ku kishte hapur sportelin mes gjetheve të dredhëzës. U ndal duke parë me vëmendje murin rrethor. Në fantazinë e tij, shtëpia ishte kështjellë, kangjellat e fshehura nga bima kacavjerrëse muret e fortifikuara, dhe vrima një e çarë e rrezikshme, lehtësisht e kalueshme.

Atëherë, papritur, edhe kësaj radhe, pa mundësi dyshimi, i pa gjethet të lëviznin nga e djathta në të majtë, duke u dridhur dhe lëkundur. Po, ishte i sigurt për këtë, gjethet lëviznin dhe dikush, sigurisht, i vinte në lëvizje.

Brenda një çasti, mendoi, që Roberti s'ishte aty, që ishte veç një lojë dhe, gjersa ishte një lojë, ai mund ta hidhte gurin; dhe, njëkohësisht, që Roberti ishte aty, dhe ai s'duhet ta hidhte gurin po që se nuk donte ta vriste. Pastaj, me një vendim të menjëhershëm dhe të shkujdesur, tendosi llastikun dhe e hodhi gurin në thellësi të gjetheve.

Duke mos qenë akoma i kënaqur, u përkul, futi në mënyrë të ethshme një gur tjetër brenda llastikut, e hodhi, mori një të tretë, e hodhi edhe atë. Tani kishte lënë mënjanë skrupuj dhe frikëra dhe nuk pyeste më ishte a s'ishte aty Roberti; përjetonte vetëm një ndjesi eksitimi të gëzueshme dhe luftarake. Më në fund, gulçues, pasi i kishte mbushur plot me vrima gjethet, e la llastikun të binte në tokë dhe u ngjit deri në murin rrethor. Siç kishte parashikuar dhe shpresuar, Roberti s'ishte aty. Por hekurat e kangjellave ishin shumë të gjera dhe të lejonin ta përkulje kokën deri në kopshtin

afër. I shtyrë nga s'e di çfarë kureshtje, u përkul dhe vështroi poshtë.

Nga ana e kopshtit të Robertit s'kishte bimë kacavjerrëse, por një lehe e mbjellë me zambakë, që ndodhej midis murit dhe rrugicës plot zall. Atëherë, tamam nën sytë e tij, midis murit dhe radhës me zambakë të bardhë dhe bojë vjollce, të shtrirë në ijë, Marçeloja pa një mace të madhe bojë hiri. Një tmerr pa kuptim ia mori frymën se vuri re pozicionin e panatyrshëm të kafshës së shtrirë më anë, me putrat e shtrira dhe të lëshuara, turirin e lëshuar mbi dheun e shkrifët. Qimja, e dendur dhe me një ngjyrë hiri në të kaltër ngjante e kreshpëruar dhe e ngatërruar lehtë dhe, njëkohësisht, e lëshuar si puplat e disa zogjve të ngordhur që kishte vënë re para ca kohësh mbi tryezën e mermertë të kuzhinës. Tani tmerrri i tij u shtua; u hodh në tokë me një kërcim, i hoqi shkopin mbështetës një trëndafilishteje, u ngjiti prapë lart dhe, duke e futur krahun në mes të hekurave, u përpoq t'ia shponte ijën maces me majën gjithë dhé të shkopit.

Po macja nuk lëvizi, papritur zambakët me kërcej të lartë e të gjelbër, me kurorat të bardha e vjollcë të përkulura mbi trupin e hirtë dhe të palëvizur, iu dukën të përmortshme si lule të vendosura nga një dorë e mëshirshme rreth një kufome. E hodhi shkopin dhe, pa u kujdesur për ta çuar dredhëzën në vend, kërceu në tokë.

E ndiente veten pre tmerresh të ndryshme dhe shtytja e tij e parë ishte të vraponte që të mbyllej në një dollap, në një skutë, pra, gjithkund ku të kishte errësirë dhe vetmi për të shpëtuar nga vetvetja. Ndiente tmerr,

në radhë të parë, se kishte vrarë macen dhe mandej, mbase në masë më të madhe, se e kishte paralajmëruar për atë vrasje të ëmën mbrëmjen e mëparshme, shenjë e padyshimtë që, në një mënyrë misterioze dhe fatale, ishte paracaktuar për të kryer veprime mizore vdekjeprurëse. Por tmerrin që shkaktonin tek ai ngordhja e maces dhe paralajmërimi kuptimplotë për këtë vdekje e kapërcente së tepërmi tmerrin që i shkaktonte ideja që, duke vrarë macen, në të vërtetë ai kishte pasur ndër mend të vraste Robertin. Vetëm rasti kishte bërë që macja të vdiste në vend të shokut. Një rast, megjithatë, jo pa kuptim; se s'mund të mohohet që kishte pasur një progresion nga lulet te hardhucat, nga hardhucat te macja dhe nga macja te vrasja e Robertit, e menduar dhe e dëshiruar, ndonëse jo e zbatuar, por ende e realizueshme dhe mbase e pashmangshme. Pra, ai ishte një anormal që s'rrinte dot pa menduar, ose më mirë pa ndier, vetëdijen e gjallë, fizike të këtij anormaliteti, një anormal i shënuar nga një fat i vetmuar dhe kërcënues dhe tashmë i drejtuar në një rrugë të përgjakshme në të cilën asnjë forcë njerëzore s'e ndalte dot. Duke përtypur këto mendime, lëvizte në mënyrë frenetike në hapësirën e shkurtër midis shtëpisë dhe kangjellave duke ngritur herë pas here sytë te dritaret e vilës, mbase me dëshirën që të shihte të shfaqej figura e nënës së tij të shkujdesur dhe mendjelehtë; por tani ajo s'mund të bënte më asgjë për ta ndihmuar edhe nëse kishte qenë ndonjëherë e aftë për të bërë diçka. Mandej, me një shpresë të papritur, vrapoi përsëri në fund të kopshtit, iu ngjiti murit dhe zgjati kokën në mes të hekurave të kangjellave. Gati-gati

kishte iluzionin se do ta gjente bosh vendin ku më parë kishte parë macen pa jetë.

Përkundrazi, macja s'kishte ikur, ishte gjithnjë atje, e hirtë dhe e palëvizur në mes të kurorës mortore të të zambakëve të bardhë e bojë vjollcë. Dhe vdekjen e dëshmonte, me një ndjesi makabre kufome të kalbëzuar, një rresht i zi me milingona që, duke u nisur nga rrugica, i ngjiteshin lehes deri te turiri, madje te sytë e kafshës. Ai vështronte dhe, papritur, si nga një përshtypje e mbivendosur, iu duk se pa në vend të maces Robertin, të shtrirë midis zambakëve, i pajetë, me milingonat që venin e vinin nga sytë e shuar deri te goja gjysmë e hapur. Me një dridhmë llahtarie, u shkëput nga ajo soditje e tmerrshme dhe kërcëu poshtë. Po kësaj radhe u kujdes ta vinte në vendin e vet sportelin prej dredhëze. Se tani, bashkë me brerjen e ndërgjegjes dhe frikës nga vetvetja, shfaqej edhe frika se mos e zbulonin dhe e dënonin.

Megjithatë, ndonëse u trembej, e ndiente se njëkohësisht i dëshironte këtë zbulim e këtë dënim; në mos tjetër, që ta ndalnin në kohë në tatëpjetën e rrëshqitshme në fund të së cilës i dukej se e priste pashmangësisht vrasja. Po prindërit s'e kishin dënuar kurrë, me sa mbante mend ai; dhe kjo nuk ndodhte aq për një koncept edukimi që përjashtonte dënimin, sesa, siç e kuptonte ai në mënyrë të vagëlluar, nga indiferentizmi. Kështu, vuajtjes që ta quante veten përgjegjës të një krimi dhe sidomos të aftë për të kryer të tjera më të rënda, i shtohej vuajtja tjetër se s'dinte kujt t'i drejtohej që ta dënonin dhe as se cili mund të ishte dënimi. Marçeloja ishte i vetëdijshëm në mënyrë

të pakuptueshme që po ai mekanizëm i brendshëm që e kishte shtyrë t'ia tregonte fajin e vet Robertit me shpresë që t'i thoshte se s'ishte faj, po diçka e zakonshme që e bënin të gjithë, tani i sugjeronte t'ia bënte të njëjtin rrëfim prindërve me shpresën e kundërt që t'i dëgjonte të thërrisnin me indinjatë se kishte kryer një krim të tmerrshëm të cilin duhet ta paguante me një dënim të përshtatshëm. Dhe s'i jepte rëndësi faktit se, në rastin e parë shfajësimi nga ana e Robertit do ta inkurajonte ta përsëriste atë veprim që, në rastin e dytë, do t'i siguronte një dënim të rreptë.

Në të vërtetë, siç e kuptonte edhe vetë, në të dyja rastet ai donte të dilte nga vetmia e tmerrshme e anormalitetit me çdo kusht dhe me çdo mjet.

Mbase do të vendoste që t'ua rrëfente prindërve vrasjen e maces po që se, po atë mbrëmje, në darkë, të mos kishte pasur ndjesinë që ata dinin tashmë gjithçka. Në fakt, sa u ul në tavolinë, vuri re me një ndjesi të përzier frike dhe lehtësimi të pasigurt që i ati dhe e ëma dukeshin armiqësorë dhe me humor të keq. E ëma, me fytyrën fëmijërore që kishte marrë një shprehje dinjiteti të ekzagjeruar, rrinte me shtatin e drejtuar, sytë e ulur, e zhytur në një heshtje qartësisht sfiduese. Përballë saj, i ati tregonte me shenja të ndryshme, po jo më pak kuptimplote, ndjenja analoge humori të keq. I ati, shumë vjet më i madh se e ëma, i jepte shpesh Marçelos ndjesinë e çuditshme se ai vetë ishte bashkuar me të ëmën në një frymë të përbashkët fëmijërore dhe të nënshtruar sikur të mos ishte për të nënë, por motër. Babai ishte i dobët, me një fytyrë të thatë e të rrudhur që ndriçohet rrallë nga të qeshura të shkurtra pa

gëzim në të cilat viheshin re dy tipare të lidhur nga diçka që pa dyshim i bashkonte: shkëlqimi pa shprehje, gati si prej minerali të bebëzave të kërcyera dhe lëvizja e shpeshtë, nën lëkurën e tendosur të faqes, të një nervi që i dridhej. Mbase nga vitet e shumta të kaluara në ushtri ai kishte ruajtur shijen për gjestet e sakta, për qëndrimet e kontrolluara. Por Marçeloja e dinte se kur i ati ishte i zemëruar, saktësia dhe kontrolli bëheshin të skajshëm, duke anuar nga e kundërta, domethënë në një dhunë të çuditshme të përmbajtur dhe të përpiktë që dukej se ngarkonte me një kuptim të veçantë gjestet më të thjeshta. Në fakt, atë mbrëmje në tavolinë, Marçeloja e vuri re menjëherë që i ati theksonte me forcë, gati duke tërhequr vëmendjen ndaj tyre, veprime të zakonshme e të parëndësishme. Bie fjala, merrte gotën, pinte një gllënjë dhe pastaj e vinte në vend me një goditje të fortë mbi tavolinë; kërkonte kriporen, merrte pak kripë prej saj dhe mandej, duke e ulur, e përplaste me një tjetër goditje; kapte bukën, e thyente dhe pastaj e ulte përsëri me një goditje të tretë. Ose, si i pushtuar nga një mani për simetri, përpiquej me disa lëvizje ta vendoste pjatën në mes të thikës, pirunit dhe lugës, të cilat bashkoheshin kështu në një kënd të drejtë rrotull rrethit të pjatës. Sikur Marçeloja të ishte më pak i shqetësuar për fajin e vet, do ta vinte re lehtë se ato gjeste, plot energji kuptimplote dhe patetike, nuk i drejtoheshin atij, por së ëmës, e cila, në fakt pas secilës goditje, e theksonte dinjitetin e vet me ca psherëtima përbuzëse dhe ca ngritje vetullash plot durim. Por shqetësimi i tij e verbonte, kështu që s'kishte dyshim se prindërit i dinin të gjitha; sigurisht Roberti, si lepur që ishte, kishte spiunuar. Ai e kishte dëshiruar dënimin, por,

duke i parë prindërit aq të vrenjtur, ndiente një neveri të papritur për dhunën për të cilën e dinte që ishte i aftë i ati në rrethana të tilla. Ashtu si shfaqjet e dashurisë të së ëmës ishin sporadike, të rastit, të nxitura më tepër nga brerja e ndërjegjes sesa nga dashuria amësore, kështu edhe rreptësitë e të atit ishin të papritura, të papërligjura, të skajshme, të nxitura, mund të thoshe, më tepër nga dëshira për të rivendosur ekuilibrin sesa nga një synim edukues. Papritur, pas një ankimi të së ëmës apo gjellëbërëses, i ati kujtohej që kishte një djalë, bërtiste, tërbohej, e godiste. Sidomos të rrahurat e trembnin Marçelon sepse i ati kishte në gishtin e vogël një unazë me një gur të madh që, gjatë këtyre skenave, s'dihej pse, gjendej përherë i kthyer nga ana e pëllëmbës së dorës, duke i shtuar rreptësisë poshtëruese të shuplakës një dhimbje më të fortë. Marçeloja dyshonte se i ati e kthente gurin nga brenda me qëllim, por s'ishte i sigurt për këtë.

Plot druajtje, i trembur, nisi të sajonte me shpejtësi një gënjeshtër të besueshme: s'e ai që kishte vrarë macen, kishte qenë Roberti dhe, në fakt, macja gjendej në kopshtin e Robertit dhe, si do ta vriste ai macen përmes dredhëzës dhe murit rrethor?

Por pastaj, papritur, iu kujtua se një mbrëmje më parë kishte paralajmëruar të ëmën për vrasjen e maces që kishte ndodhur, në të vërtetë, një ditë më vonë, dhe e kuptoi se e kishte rrugën të mbyllur për çdo gënjeshtër. Sado e hutuar që të ishte e ëma, sigurisht ia kishte treguar rrëfimin e tij të atit, i cili, me jo më pak siguri, kishte vendosur lidhjen midis atij rrëfimi dhe akuzave të Robertit dhe kështu që s'kishte asnjë mundësi përgënjeshtrimi. Kur i erdhi ky

mendim, duke kaluar në një skaj në tjetrin, me një shtytje të përtërirë, ai e dëshiroi dënimin, mjaft që të vinte shpejt dhe të ishte vendimtar. Cili dënim? Iu kujtua që Roberti një ditë kishte folur për kolegjet si vende ku prindërit fusnin fëmijët çapkenë për dënim dhe u çudit duke vënë re se e dëshironte me qejf këtë lloj dënimi.

Në këtë dëshirë ishte e pranishme lodhja e pavetëdijshme nga jeta familjare e çrregullt dhe me pak dashuri, duke e bërë jo vetëm të ëndërronte për diçka që prindërit do ta quanin dënim, po edhe duke e shtyrë të mashtronte veten dhe nevojën për këtë dënim me llogaritjen gati dinake që, në këtë mënyrë, do ta zbuste njëkohësisht pendimin e vet dhe do ta përmirësonte gjendjen e vet. Ky mendim i sugjeroi në çast disa përfytyrime që duhet të ishin tronditëse dhe, përkundrazi, i pëlqenin: një ndërtesë hijerëndë e të ftohtë bojë hiri me dritaret të mëdha të mbyllura me hekura; dhoma të mëdha fjetjeje të ftohta dhe pa zbukurime, me ca radhë shtretërisht të rreshtuar nën mure të mëdha të bardha; klasa të shpëllara, plot banka, me katedrën në fund; korridore të zhveshura, shkallë të errëta, dyer të rënda, kangjella të pakapërcyeshme; pra, gjithçka si në një burg, po të gjitha të parapëlqyera para lirisë së pavlerë, të anktshme, të padurueshme të shtëpisë atërore. Madje edhe ideja për të mbajtur një uniformë pambuku me vija dhe për ta pasur kokën të rruar si nxënësit e kolegjeve që takonte nganjëherë të rreshtuar nëpër rrugë, madje edhe kjo ide poshtëruese dhe gati e neveritshme i ngjante e këndshme në aspiratën e vet të tanishme të dëshpëruar për një rregull dhe një normalitet çfarëdo.

I humbur në këto fantazira, s'e shikonte më të atin, po mbulesën që shkëlqente nga drita e bardhë mbi të cilën, herë pas here, përplasheshin insektet e natës që nga dritarja e hapur ndesheshin pas abazhurit. Mandej ngriti sytë dhe arriti në kohë për të vënë re, tamam prapa të atit, në pezulin e dritares, profilin e një maceje. Por kafsha, para se ai t'ia dallonte ngjyrën, kërceu poshtë, përshkoi dhomën e bukës dhe u zhduk nga ana e kuzhinës. Ndonëse s'ishte krejt i sigurt, megjithatë zemra iu fry nga shpresa e gëzueshme se mund të ishte fjala për macen që pak orë më parë e kishte parë të shtrirë të palëvizshme midis zambakëve, në kopshtin e Robertit. Dhe u gëzua nga kjo shpresë, shenjë që në fund të fundit i interesonte më tepër jeta e kafshës sesa fati i vet.

- Macja, - thirri me zë të lartë. Dhe mandej, duke e hedhur pecetën mbi tavolinë dhe duke shtrirë një këmbë jashtë karriges, tha: - Babi, mbarova, a të ngrihem?

- Ti rri në vendin tënd, - i tha i ati me zë kërcënues.

Marçeloja, i trembur, guxoi të thoshte:

- Po macja është gjallë...

- Të thashë të rri në vendin tënd, - theksoi i ati. Mandej, sikur fjalitë e Marçelos, të kishin thyer edhe heshtjen e tij, u kthye nga e shoqja duke thënë:

- Atëherë, thuaj diçka, fol.

- S'kam asgjë për të thënë, - u përgjigj ajo me një dinjitet të ekzagjeruar, me qepallat e ulura dhe buzët përbuzëse. Ishte veshur si për mbrëmje, me një fustan të zi dekolte. Marçeloja vuri re se shtrëngonte midis gishtërinjve të hollë një shami të vogël që e çonte shpesh te hunda; me dorën tjetër kapte dhe lëshonte

mbi tavolinë një copë bukë, por jo me gishtërinj, por me majat e thonjve, si zog.

- Po thua je atë që ke për të thënë... fol... për besë.

- S'kam asgjë për të të thënë ty.

Marçeloja mezi po e merrte vesh se shkaku i humorit të keq të prindërve s'ishte vrasja e maces, kur papritur gjithçka sikur u rrokullis. I ati përsëriti edhe një herë:

- Fol, dreqi e mori.

E ëma, në vend të përgjigjes, ngriti supet, atëherë i ati e mori gotën në formë kupe që ishte para pjatës dhe duke thirrur me zë të lartë tha:

- A do të flasësh apo jo? - e përplasi me forcë gotën mbi tavolinë. Gota u thye, dhe babai me një sharje e çoi dorën e plagosur gjër në gojë, e ëma e trembur u ngrit nga tavolina dhe u drejtua me nxitim nga dera. Babai thithte gjakun nga dora gati me epsh, duke harkuar vetullat përmbi dorë, por duke e parë të shoqen të ikte, ndërpreu thithjen dhe i thirri:

- Të ndaloj të ikësh... e kuptove.

Si përgjigje erdhi zhurma e derës e përplasur me forcë. Babai u ngrit dhe u turr drejt derës. I eksituar nga skena e dhunshme, Marçeloja e ndoqi prapa.

I ati ishte ngjitur tashmë mbi shkallë, duke mbajtur dorën te parmaku, pa e bërë veten dhe, pa u nxituar, në dukje; po Marçeloja që e ndiqte pas, vuri re se i ngjiste shkallët dy nga dy, gati duke fluturuar në heshtje drejt kryeshkallës, ashtu siç mendoi ai, një div përralle që kishte mbathur çizmet e shtatë legave dhe nuk dyshoi asnjë çast që kjo ngjitje e llogaritur dhe kërcënuese do ta mposhte nxitimin e çrregullt të nënës që pak më lart ishte nëpër shkallë, duke i ngjitur një nga një, me këmbët e penguar

nga fundi i ngushtë. “Tani e vret”, mendoi, duke e ndjekur të atin. Si arriti te kryeshkalla, e ëma bëri një vrap të shkurtër deri te dhoma e vet, po jo me aq nxitim sa ta ndalonte të shoqin të futej pas saj nga dera e hapur. Të gjitha këto Marçeloja i pa, duke i ngjitur shkallët me këmbët e veta të shkurtra prej fëmije, që s’i lejonin as të ngjiste shkallët dy nga dy si i ati, as të kërcente me nxitim si e ëma. Si arriti te kryeshkalla, vuri re se zhurmën e ikjes tani e kishte zëvendësuar, çuditërisht, një heshtje e papritur. Dera e dhomës së nënës kishte mbetur hapur. Marçeloja, disi ngurrues, futi kokën te pragu.

Në fillim nuk pa gjë, në fund të dhomës, në gjysmëhije, në të dyja anët e krevatit të madh të ulët, veçse dy perdet e mëdha të holla të dritareve, të ngritura nga një rrymë ere brenda dhomës, lart drejt tavanit gati duke e prekur llambën qendrore. Ato perde të heshtura të bardha që rrinin pezull në ajër në dhomën e errët, të jepnin një ndijim shkretëtire sikur, duke ndjekur njëri-tjetrin, prindërit e Marçelos të kishin fluturuar nga dritaret e hapura, në natën verore.

Më në fund, në atë vijë drite që arrinte te krevati nga korridori, nëpërmjet derës, i vuri re më në fund prindërit. Më mirë, s’pa veçse të atin nga shpina, nën të cilën e ëma ishte zhdukur gati plotësisht me përjashtim të flokëve të shpërndara mbi jastëk dhe një krah të ngritur drejt ballit të shtratit. Ai krah po përpiquej, duke u përpëlitur të kapej me dorë pas ballit të shtratit, pa ia arritur megjithatë qëllimit; dhe ndërkaq i ati, duke shtypur trupin e gruas, bënte me supe e me duar disa gjeste sikur të kishte dashur ta mbyste. “Po e vret”, mendoi Marçeloja, i bindur për këtë, duke u ndalur në

prag. Ndiente në atë çast një ndijim të pazakonshëm eksitimi luftarak dhe mizor dhe, në të njëjtën kohë, një dëshirë të fuqishme për të ndërhyrë në atë luftë, s'e dinte as vetë, nëse donte të mbështeste të atin a të mbronte të ëmën. Njëkohësisht gati po i buzëqeshte shpresa të shihte, nëpërmjet atij krimi shumë më të rëndë, shlyerjen e fajit të tij: në fakt, ç'ishte vrasja e një maceje në krahasim me atë të një gruaje? Po, tamam në çastin kur, duke mposhtur ngurrimin e fundit, i joshur dhe plot egërsi, po lëvizte nga pragu, zëri i së ëmës, aspak i mbytur dhe madje gati përkëdhelës murmuriti ngadalë "lërmë" dhe, në kundërshtim me atë lutje, krahu që ajo e kishte mbajtur gjer atëherë të ngritur për të kërkuar ballin e krevatit, u ul për të rrethuar zverkun e të shoqit. I çuditur dhe gati i zhgënjyer, Marçeloja u zmbraps dhe doli në korridor.

Duke u përpjekur të mos bënte zhurmë mbi shkallë, zbriti në katin përdhes dhe u drejtua nga kuzhina. Tani e shponte përsëri kureshtja të dinte nëse macja që ishte hedhur nga dritarja poshtë në dhomën e bukës ishte ajo që kishte frikë se e kishte vrarë. Shtyu derën e kuzhinës. Iu duk një tablo e qetë shtëpiake: gjellëbërësja, në moshë të pjekur dhe kamerierja e re, të ulura në tavolinën prej mermeri, duke ngrënë, në kuzhinën e bardhë, midis furnelës elektrike dhe frigoriferit. Dhe, në tokë, nën dritare, macja që po lëpinte me gjuhën e trëndafilte qumështin e një filxhani.

Por menjëherë vuri re i zhgënjyer se nuk ishte macja e hirtë, por një mace me njolla në ngjyra të ndryshme.

Duke mos ditur si ta përligjte praninë e vet në kuzhinë, u drejtua nga macja, u ul dhe e përkëdheli në kurriz.

Macja, pa e ndërprerë lëpirjen e qumështit, nisi të gërhiste. Gjellëbërësja u ngrit dhe vajti të mbyllte derën. Mandej hapi frigoriferin, nxori së andejmi një pjatë me një copë ëmbëlsirë, e mbështeti në tavolinë dhe, duke afruar një karrige, i tha Marçelos:

- A do pak nga ëmbëlsira e mbrëmshme? E vura mënjanë tamam për ty.

Marçeloja, pa thënë asnjë fjalë, la macen, u ul dhe nisi të hante ëmbëlsirën. Kamerierja i tha:

- Veçse unë ca gjëra nuk i kuptoj... kanë aq kohë gjatë ditës, kanë gjithë atë vend në shtëpi dhe tamam në tavolinë, në sy të fëmijës, duhet të zihen.

Gjellëbërësja, duke moralizuar, iu përgjigj:

- Kur s'ke nge të merresh me fëmijët, është më mirë të mos i lindësh.

Kamerierja, pas një heshtjeje të shkurtër, vërejt:

- Ai, për moshën që ka, mund të ishte babai i saj... Kuptohet qartë që nuk shkojnë...

- Sikur të ishte vetëm kjo... - tha gjellëbërësja me një vështrim të rëndë në drejtim të Marçelos.

- Mandej, - vazhdoi kamerierja, - sipas meje ai burrë s'është normal...

Marçeloja, kur dëgjoi këtë fjalë, edhe duke vazhduar të hante ngadalë ëmbëlsirën, zgjati veshët.

- Edhe ajo mendon si unë, - vazhdoi kamerierja, - e di se ç'më ka thënë pardje kur po e zhvishja për gjumë? "Xhakomina, një ditë a një tjetër, im shoq do më vrasë..." Unë iu përgjigja: "Po, zonjë, ç'prisni që nuk e lini?" Dhe ajo...

- Shëëët, - e ndërpreu gjellëbërësja duke treguar Marçelon. Gjellëbërësja e kuptoi dhe pyeti Marçelon:

- Ku janë babai e mamaja?

- Lart në dhomë, - iu përgjigj Marçeloja. Dhe pa prituri, si i nxitur nga një shtytje e pandalshme, shtoi: - Është e vërtetë që babi s'është normal. A e dini ç'ka bërë?

- Jo, çfarë?

- Ka vrrarë një mace, - tha Marçeloja.

- Një mace, e qysh?

- Me llastikun tim... E pashë vetë në kopsht tek ndiqte një mace të hirtë që ecte mbi mur... Mandej mori një gur, ia hodhi maces dhe e goditi në njërin sy... Macja ra në kopshtin e Robertinos, pastaj unë vajta ta shoh dhe pashë që kishte ngordhur. Ndërsa fliste, kishte marrë zjarr, pa hequr dorë nga toni i një të pafajshmi që me një naivitet të çiltër prej njeriu që s'kupton, tregon ndonjë krim që ka parë me sy.

- Pa mendoje, - tha kamerierja duke bashkuar duart, - një mace... një burrë i moshuar, një zotëri, të marrë llastikun e të birit dhe të vrasë një mace... dhe pastaj të mos thuash se është anormal.

- Kush është i keq me kafshët, është i keq edhe me njerëzit, - tha gjellëbërësja, - fillohet me një mace dhe pastaj vritet një njeri.

- Pse? - pyeti papritur Marçeloja duke ngritur sytë nga pjata.

- Ashtu thonë, - u përgjigj gjellëbërësja duke e përkëdhelur.

- Megjithatë, - shtoi duke iu drejtuar kamerieres, - s'është e vërtetë... Ai burri që vrau gjithë ata njerëz në Pistoia... e lexova në gazetë... A e di se ç'bën tani në burg? Rrit një kanarinë.

Ëmbëlsira kishte mbaruar. Marçeloja u ngrit dhe doli nga kuzhi

II

Gjatë verës, në plazh, tmerri i fatalitetit, i shprehur aq thjesht nga gjellëbërësja, “fillohet me një mace dhe pastaj vritet një njeri”, dalëngadalë u zhduk nga shpirti i Marçelos. Ai mendonte ende shpesh për atë lloj mekanizmi të pakuptueshëm dhe të pamëshirshëm ku duket se ishte ngatërruar brenda disa ditësh jeta e tij; por gjithnjë e më me pak frikë, më tepër si për një sinjal alarmi sesa për dënimin e paapelueshëm nga i cili kishte pasur frikë për ca kohë. Ditët kalonin të gëzueshme, të përvëluara nga dielli, të dehura nga kripa e athët e detit, të shumëllojshme në dëfrime e zbulime; dhe Marçelos, në çdo ditë që kalonte, i dukej se arrinte, s’dihet se çfarë fitoreje, jo aq kundër vetes që s’e kishte ndier kurrë fajtor të vetëdijshëm, sa kundër forcës së errët, keqbërëse, dinake dhe të huaj, të ngjyrosur me ngjyrat e errëta të fatalitetit dhe fatkeqësisë dhe që e kishte çuar, pothuajse pa dashjen e tij nga shkatërrimi i luleve në masakrën e hardhucave dhe, së këndejmi, në orvatjen për ta vrarë Robertin. Atë forcë e ndiente gjithnjë të pranishme dhe

kërcënuese edhe nëse jo zotëruese; ashtu sikur ndodh në makthet, kur je i trembur nga prania e një përbindëshi dhe mendon ta zbusësh duke bërë sikur fle, kur në fakt gjithçka është një ëndërr që bëhet duke fjetur; i dukej se duke mos mundur ta largonte përfundimisht kërcënimin e asaj force, i interesonte ta vinte në gjumë, si të thuash, duke përfytyruar një harresë të shkujdesur që ishte ende larg për ta arritur. Ajo që një nga verërat më të shfrenuara, në mos më të lumtura të Marçelos dhe sigurisht e fundit verë që ai e ndjeu veten fëmijë pa neveri për fëmijërinë dhe pa dëshirë të dilte prej saj. Pjesërisht ajo shkujdesje i detyrohej prirjes së natyrshme të moshës; por pjesërisht edhe nga vullneti për të dalë me çdo kusht nga rrethi i mallkuar i parandjenjave dhe i fatalitetit. Marçeloja s'ishte i vetëdijshëm për këtë, por nxitja që e shtynte të kridhej në ujin e detit dhjetë herë brenda një mëngjesi; të bënte gara çapkenllëqesh me shokët më të fortë; të voziste me lopata me orë mbi detin e përvëluar; domethënë të bënte me zell të skajshëm të gjitha gjërat që bëhen nëpër plazhe; ishte po ajo nxitje që e kishte shtyrë të kërkonte bashkëfajësinë e Robertit pas masakrës së hardhucave dhe dënimit e prindërve pas ngordhjes së maces; një dëshirë për normalitet; një vullnet për t'iu përshtatur një rregulle të pranuar dhe të përgjithshme; një dëshirë për të qenë si gjithë të tjerët, derisa të ishte ndryshe do të thoshte të ishte fajtor. Po karakteri i vullnetshëm dhe artificial i kësaj sjelljeje të tij shfaqej herë pas here në kujtimin e papritur dhe të dhimbshëm të maces së ngordhur, të shtrirë midis zambakëve të bardhë e bojë vjollce, në kopshtin e

Robertos. Ai kujtim e trembte siç e tremb borxhliun kujtimi i nënshkrimit të vet në fund të dokumentit që vërtetonte borxhin e tij. I dukej sikur me atë vrasje kishte marrë përsipër një angazhim të errët dhe të tmerrshëm, të cilit herët a vonë s'do të mund t'i shmangej edhe sikur të ishte fshehur nën dhé a të kishte kapërcyer oqeanet për të humbur gjurmët e veta. Në ato çaste ngushëllohej me mendimin se kishin kaluar një muaj, ky muaj, tre muaj, dhe së shpejti do të kalonte një vit, dy vjet, tre vjet; dhe, sidoqoftë, ajo që kishte më shumë rëndësi ishte të mos e zgjoje përbindëshin dhe të lije kohën të kalonte. Nga ana tjetër, këto kriza dëshpërimi dhe frike ishin të rralla dhe nga fundi i verës morën fund krejt. Pasi Marçeloja u kthye në Romë, nuk i mbeti nga episodi i maces dhe nga të tjerët që kishin ardhur para tij veçse një kujtim i zbehtë, gati i tejdukshëm. Si kujtimi i një përvoje që mbase ai kishte jetuar, por në një jetë tjetër me të cilën s'kishte lidhje të tjera përveçse një kujtimi të papërgjegjshëm dhe pa pasoja.

Në këtë harresë ndihmoi, gjithashtu, si u kthye në qytet, eksitimi i hyrjes në shkollë. Marçeloja gjer atëherë kishte studiuar në shtëpi dhe ky ishte viti i tij i parë në shkollën publike. Risitë e të pasurit shokë, profesorë, klasa, e orare, risi në të cilat shkëlqente, edhe në një shumëllojshmëri aspektesh, një ide rregulli, disipline dhe pune të përbashkët, i pëlqyen mjaft Marçelos pas çrregullimit, mungesës së rregullave dhe vetmisë së shtëpisë së tij. Ishte deri diku kolegji për të cilin ai kishte ëndërruar atë ditë, në tavolinë, por pa shtrëngesa, as skllavëri, vetëm me aspektet e tij të këndshme dhe pa ato të pakëndshmet që

e bënin të ngjante me një burg. Marçeloja e vuri re shumë shpejt që një prirje e thellë e çonte drejt jetës shkollore. I pëlqente të ngrihej në mëngjes në orë të caktuar, të lahej e të vishej shpejt, të mbyllte pakon e vet me libra dhe fletore, të shtrënguar e të dukshme në pëlhurën e dyllosur të lidhur me lastik dhe të nxitonte në rrugë drejt shkollës. I pëlqente të turrej bashkë me turmën e shokëve në gjimnazin e vjetër, të vraponte nëpër shkallët e ndyra, nëpër korridorët e shkreta dhe kumbues dhe mandej të zbuste në klasë vrullin e vrapimit, midis bankave të rreshtuara para katedrës bosh.

I pëlqente, veçanërisht, rituali i mësimëve, hyrja e profesorit, thirrja e emrave të nxënësve, pyetjet, gara me shokët për t'iu përgjigjur pyetjeve, fitoret dhe disfatat e kësaj gare, toni i qetë, neutral i zërit të mësuesit, vetëvendosja aq kuptimplote e klasës, të gjithë ata në rresht të bashkuar nga vetë nevoja për të mësuar para profesorit që jepte mësim. Megjithatë Marçeloja ishte një nxënës mesatar dhe, në disa lëndë, madje një nga të fundit. Ajo që pëlqente në shkollë s'ishte edhe aq studimi sa një mënyrë e re jetese, që i afrohej më shumë shijeve të tij, sesa ajo që kishte ndjekur gjer tani. Ishte përsëri normaliteti që e tërhiqte; dhe, për më tepër se shfaqej jo i rastit, as i varur nga parapëlqimet dhe prirjet e natyrshme të shpirtit, por i paravendosur, i paanshëm, indiferent ndaj shijeve individuale, i kufizuar dhe i mbështetur nga rregulla të padiskutueshme dhe të gjitha të drejtuara drejt një synimi të vetëm.

Por mungesa e përvojës dhe naiviteti i tij e bënin të ngathët e të pasigurt para rregullave të tjera, të heshtura,

por që ekzistonin, që lidheshin me marrëdhëniet e fëmijëve midis tyre, jashtë disiplinës shkollore. Edhe ky ishte një aspekt i normalitetit të ri, por më i vështirë për t'u zotëruar. E ndjeu për herë të parë kur e thirrën në katedër për të treguar detyrën me shkrim. Meqenëse profesori ia mori nga dora fletoren dhe, duke e mbështetur në katedër, para vetes, filloi ta lexonte, Marçeloja, i mësuar me marrëdhëniet e dashura që i kishin mësuar në shtëpi, në vend që të rrinte veçan mbi podium duke pritur përgjigjen, në mënyrë tepër të natyrshme vuri një krah rreth supeve të mësuesit dhe uli fytyrën pranë tij për ta ndjekur bashkë me të leximin e detyrës. Profesori u kufizua vetëm, pa treguar asnjë habi, të hiqte dorën që Marçeloja i kishte vënë mbi sup dhe të çlirohej nga krahu; por gjithë nxënësit shpërthyen në një të qeshur të zhurmshme në të cilën Marçelos iu duk se vinte re një qortim të ndryshëm nga ai i profesorit, shumë më pak i butë dhe mirëkuptues.

Me atë gjest naiv, mendoi më vonë pasi e kapërceu ndjenjën e turpfit, ai kishte shkelur njëkohësisht dy rregulla të ndryshme: atë shkollore, që kërkonte që ai të ishte i disiplinuar dhe të respektonte profesorin, dhe atë të fëmijëve, që kërkonte që ai të ishte i djallëzuar dhe të mos i shfaqte ndjenjat. Dhe ajo që ishte akoma më e çuditshme, ato dy rregulla nuk e kundërshtonin njëra-tjetrën, madje e plotësonin, në mënyrë të mistershme.

Por, ashtu siç ai e kuptoi menjëherë, në rast se ishte mjaft e lehtë të bëheshe shpejt një nxënës i zoti, ishte shumë më e vështirë të bëheshe një shok i shkathët dhe i shpenguar. Këtë shndërrim të dytë e pengonin

mungesa e tij e përvojës, zakonet e tij familjare, madje edhe pamja e tij fizike.

Marçeloja kishte trashëguar nga e ëma një përsosmëri tiparesh gati nazemadhe për rregullsinë dhe ëmbëlsinë e vet. Kishte një fytyrë të rrumbullakët, me faqet brune dhe delikate, hundën të vogël, gojën dredha-dredha me shprehje tekanjoze dhe të vrenjtur, mjekrën e dalë dhe nën balluken e flokëve gështenjë që ia mbulonte gati tërë ballin, sy të kaltër në të hirtë me një shprehje disi të zymtë, ndonëse naive dhe përkëdhelëse. Ishte pothuajse një fytyrë vajze; por djemtë, aq të pagdhundur siç ishin, mbase s'do ta vinin re nëse ëmbëlsia dhe bukuria e fytyrës të mos theksohej nga disa tipare gati femërore, aq sa mund të dyshohej se mos Marçeloja s'ishte vërtet një vajzë e vogël e veshur si çuan: një lehtësi e pazakonshme për t'u skuqur, një prirje e pandalshme për ta shprehur dhembshurinë e shpirtit me gjeste përkëdhelëse, një dëshirë për t'u pëlqyer të tjerëve e shtyrë deri në servilizëm dhe koketeri. Ato tipare ishin të lindura te Marçeloja, pra, të pavetëdijshme; kur vuri re se e bënin qesharak në sy të djemve, tani ishte tepër vonë; edhe sikur të mund t'i kontrollonte, në mos t'i zhdukte, nami i tij si vajzë me pantallona tashmë ishte vendosur.

Talleshin me të në një mënyrë gati automatike sikur karakteri i tij femëror të ishte tashmë i padiskutueshëm. Herë e pyesninin me një seriozitet të shtirur pse nuk ulej në bankat e vajzave dhe pse e kishte ndërruar fundin me pantallonat; herë si e kalonte kohën në shtëpi, duke qëndisur a duke luajtur me kukulla; herë pse s'i kishte vrimat në lllapat e veshëve për të futur aty vathët. Nganjëherë i fushnin në bankë një copë stofi me gjilpërë

dhe një lëmsh me pe, një aluzion i qartë për atë lloj pune së cilës duhet t'i kushtohet; një herë tjetër një kuti me pudër; një mëngjes, madje, një sutjen rozë, që njëri nga djemtë ia kishte vjedhur motrës së madhe. Që në fillim, duke e shndërruar emrin e tij në një llogarë përkëdhelës femëror, e kishin quajtur Marçelina.

Ai ndiente përballë këtyre talljeve një ndjenjë inati të përzier me njëfarë kënaqësie prej të mikluari sikur një pjesë e tij, në thellësi, të mos ishte edhe aq e pakënaqur; por nuk e thoshte dot nëse kjo kënaqësi i detyrohej cilësisë së talljes apo faktit se shokët interesoheshin për të, qoftë edhe për ta tallur. Por një mëngjes që, si zakonisht, i pëshpëritnin prapa krahëve: “Marçelina... Marçelina... A s'është e vërtetë që ke brekë vajzash?”. Ai u ngrit dhe, duke e ngritur dorën për të folur, u ankua me zë të lartë, në heshtjen e papritur të klasës, se e thërrisnin me një llogarë femëror. Profesori, një burrë i fuqishëm me mjekër, e dëgjoi duke buzëqeshur nën qimet e mjekrës së thinjur dhe menjëherë tha:

- Të thërrasin me një llogarë femre... dhe cili është?
- Marçelina, - tha Marçeloja.
- Dhe të vjen keq?
- Sigurisht... se jam burrë.
- Hajde këtu, - tha profesori. Marçeloja u bind dhe iu afrua katedrës. - Tani, - vazhdoi me endje profesori, - tregojta muskujt e tu klasës.

Marçeloja, i bindur, e përkuli krahun duke fryrë muskujt.

Profesori u zgjat nga katedra, i preku krahun, tundi kokën në shenjë miratimi ironik, dhe mandej, duke iu drejtuar nxënësve, tha:

- Siç e shihni, Kleriçi është një djalë i fortë... dhe është gati të tregojë se është burrë dhe jo grua... kush do ta sfidojë? Paso i një heshtjeje të gjatë, profesori e hodhi vështrimin mbi klasë dhe pastaj përfundoi: - Asnjë... Atëherë kjo është shenjë se keni frikë prej tij... prandaj mos e quani më Marçelina.

Gjithë nxënësit shpërthyen në të qeshura. I skuqur në fytyrë, Marçeloja u kthye në vendin e vet.

Por, që nga ajo ditë, në vend që të pushonin, talljet u shtuan, të ashpërsuara mbase nga fakti se Marçeloja, siç i thanë, kishte spiunuar duke e thyer në këtë mënyrë ligjin e heshtur të bashkëfajësisë që i lidhte djemtë midis tyre.

Marçeloja ishte i vetëdijshëm se për t'i bërë talljet të pushonin duhet t'u tregonte shokëve që s'ishte aq delikat sa dukej; por e merrte me mend, me intuitë, se për të vërtetuar diçka të tillë nuk mjaftonte që të tregonte muskujt e krahut, siç i kishte sugjeruar profesori. Duhej diçka më e pazakonshme, që të godiste fantazinë dhe të zgjonte admirimin. Çfarë? S'do të mund ta thoshte me saktësi, por në një kuptim të përgjithshëm një veprim a një send që të sugjeronin ide force, burrërie, në mos brutaliteti. Kishte vënë re që shokët e admironin shumë njëfarë Avancini, ngaqë zotëronte një palë dorashka të mëdha boksi prej lëkure. Ato dorashka, Avancini, një leshverdhë i dobët, më i shkurtër dhe më pak i fortë se ai vetë, s'dinte as t'i përdorte; megjithatë, për shkak të tyre kishte fituar një konsideratë të veçantë. Një admirim të ngjashëm kishte fituar njëfarë Puljeze që e njihnte apo pretendonte se e njihnte, një goditje lufte japoneze, që në mënyrë të pagabueshme e mposhtte kundërshtarin. Kur i kishin kërkuar ta zbatonte, Puljezeja,

në fakt, s'kishte arritur ta bënte, megjithatë djemtë e respektonin ashtu si Avancinin.

Marçeloja e kuptonte se duhej të mburrej sa më shpejt për zotërimin e një sendi si dorashkat ose të gjente ndonjë trimëri të llojit të luftës japoneze; por e kuptonte se s'ishte aq mendjelehtë dhe diletant si shokët e vet; t'i përkiste, përkundrazi, i pëlqente apo jo, racës së atyre që marrin seriozisht jetën dhe angazhimet e saj; dhe se, ndryshe nga Avancini, do t'u thyente hundën kundërshtarëve të vet dhe, ndryshe nga Puljeze, do t'u thyente qafën. Ajo paafësi e tij për retorikë dhe sipërfaqësi i frymëzonte një mosbesim të errët ndaj vetvetes; kështu, ndërsa dëshironte t'ua jepte shokëve atë provë force që dukej se ata ia kërkonin si çmim në këmbim të konsideratës së tyre, njëkohësisht trembej prej saj në mënyrë jo të qartë.

Një nga ato ditë vuri re që disa nga djemtë, më të vendosurit nga të gjithë, për ta tallur, bisedonin midis tyre dhe iu duk se kuptonte nga vështrimet e tyre se po përgatitnin ndonjë shaka tjetër në dëm të tij. Megjithatë, ora e mësimit rrodhi pa ndonjë të papritur, ndonëse vështrimet dhe murmuritjet ia forconin dyshimin. Erdhi sinjali i daljes dhe Marçeloja, pa vështruar përreth, u drejtua nga shtëpia. Ishin ditët e para të nëntorit me një ajër të stuhishëm dhe të butë, në të cilin dukej se përziheshin ngrohtësia dhe aromat e fundit të verës tashmë të mbaruar me rreptësinë e pasigurt të fillimit të vjeshtës. Marçeloja e ndiente veten të eksituar në mënyrë të paqartë nga kjo atmosferë zbrazjeje dhe shkatërrimi të natyrshëm, në të cilën ndiente një ankth

shkatërrimi dhe vdekjeje shumë të ngjashëm me atë që, para disa muajve, e kishte shtyrë t'ua priste kokën luleve dhe të vriste hardhucat. Vera kishte qenë një stinë e palëvizshme, e përsosur, e plotë, nën një qiell të qetë, me pemë plot gjethe dhe degë plot zogj.

Tani ai shihte me endje erën e vjeshtës tek griste e shkatërronte atë përsosmëri, atë plotësi, atë palëvizshmëri duke shtyrë në qiell re të errëta të grisura, duke ua shkukur gjethet pemëve dhe duke i hedhur në tokë, duke zbuar zogjtë që, në fakt, dukeshin që largoheshin midis gjetheve dhe reve, në radhë të rregullta. Në një kthesë vuri re se e ndiqte pas një grup me pesë shokë dhe s'kishte dyshim që ndiqnin tamam atë, sepse dy prej tyre banonin në drejtim të kundërt, por i zhytur në ndijimet e veta të vjeshtës, nuk iu dha rëndësi.

Tani nxitonte për të arritur një shëtitore të madhe të mbushur me rrape nga ku, nëpërmjet një rruge të tërthorët, arrihej te shtëpia e tij. E dinte se gjethet e vdekura në atë shëtitore grumbulloheshin me mijëra mbi trotuare, të verdha dhe të kumbueshme dhe e shijonte që tani kënaqësinë që të zvarriste këmbët në grumbuj duke i prishur dhe duke i bërë të kërcisnin. Ndërkaq, gati për lojë, përpiquej që t'i bënte ndjekësit e vet të humbitnin gjurmët, herë duke u futur në ndonjë derë të madhe, herë duke u ngatërruar me turmën. Por të pestët, siç e vuri re, pas një çasti pasigurie, e gjenin gjithnjë përsëri. Tani shëtitorja ishte afër dhe Marçeloja ndiente turp që ta shihnin duke luajtur me gjethet e vdekura. Atëherë vendosi t'i përballonte ata dhe, duke u kthyer papritur, pyeti:

- Pse më ndiqni? Një nga të pestët, leshverdhi me fytyrën me majë dhe kokën të rruar, u përgjigj në çast:

- S'po të ndjekim aspak, rruga është e të gjithëve, apo jo?

Marçeloja s'tha asgjë, por e vazhdoi prapë rrugën.

Ja ku ishte shëtitorja, midis dy radhësh me rrape vigane dhe të zhveshure, me shtëpitë plot me dritare të rreshtuara pas rrapeve, ja gjethet e vdekura, të verdha si floriri, të shpërndara mbi asfaltin e zi dhe të grumbulluara ndër gropa. Ata të pestë tani nuk shiheshin më, mbase kishin hequr dorë nga ndjekja dhe ai ishte vetëm në shëtitorën e gjerë me trotualet e shkreta. Pa nxituar u fut me këmbë midis gjethëve të shpërndara mbi kalldrëm dhe filloi të ecte ngadalë duke u kënaqur tek zhyste këmbët deri në gju në atë masë të lëvizshme e të lehtë gjethesh të vdekura kumbuese.

Por, ndërsa po përkulej për të kapur një grumbull gjethesh me qëllim për t'i hedhur në ajër, ndjeu përsëri zërat tallës: "Marçelina... Marçelina, pa na i trego një çikë brekët". Atëherë, papritur, ndjeu një etje për të luftuar, gati të këndshme, që ia ndezi fytyrën me një eksitim luftarak. U ngrit prapë dhe vajti i vendosur t'i takonte ndjekësit e vet duke u thënë: "A do të ikni apo jo?".

Në vend që të përgjigjeshin, iu hodhën që të pestë përsipër.

Marçeloja kishte menduar të bënte, në njëfarë mënyre, si Oracët dhe Kuriacet sipas anekdotës së librave të historisë*; t'i kapte një nga një, duke vrapuar

* Anekdotë nga historia e lashtë e Romës (shën. i përkth.).

nga një anë në tjetrën dhe t'i jepte secilit një goditje të keqe në mënyrë që t'i bindte për të hequr dorë nga qëllimi i tyre. Por e vuri re menjëherë që ky plan ishte i paralizueshëm: në mënyrë parashikuese të pestë ishin shtrënguar të gjithë së bashku pas tij dhe tani po e mbanin, njëri nga krahët, njëri nga këmbët dhe dy nga gjysma e trupit. I pesti, siç e vuri re ai, kishte hapur, ndërkohë, me nxitim një pako dhe tani po i afrohej me kujdes, duke mbajtur pezull një fund prej vajze të vogël, prej pambuku të kaltër. Të gjithë qeshnin tani duke e mbajtur të palëvizur dhe ai, i fundit, tha:

- Hajt, Marçelina, na lër... do të ta veshim fundin dhe pastaj do të të lëmë të ikësh te mami.

Ishte, pra, tamam, ajo lloj shakaje që kishte parandier Marçeloja, shaka e sugjeruar, si zakonisht, nga pamja e tij jo aq mashkullore. Flakë i kuq në fytyrë, i tërbuar nga inati, nisi të përpëlitej me forcë të jashtëzakonshme; po ata të pestë ishin më të fortë dhe, ndonëse arriti t'ia gërvishte fytyrën njërit dhe ta godiste me grusht në stomak tjetrin, e ndjeu se, gradualisht, lëvizjet e tij ngadalësoheshin. Më në fund, ndërsa rënkonte “më lini... idiotë... më lini”, një britmë triumfi u shpëtoi nga goja, ndjekësve të tij: fundi po i zbriste mbi kokë dhe protestat e tij humbitnin brenda atij lloj thesi. Ai u përpëlit përsëri, por më kot. Me shkathtësi djemtë arritën t'ia zbrisnin fundin deri në bel; dhe mandej ai ndjeu se po ia lidhnin me një nyje në shpinë. Atëherë, ndërsa ata bërtisnin “shtrëngoje... jepi... më fort”, dëgjoi një zë të qetë që pyeste, më tepër me tonin e kureshtjes sesa të qortimit:

- Po çfarë po bëni kështu?

Menjëherë të pestë e lanë duke ikur me vrap; dhe ai u gjet vetëm, flokëshprishur dhe gulçues, me fundin e lidhur pas belit. Ngriti sytë dhe pa para vetes në këmbë, burrin që kishte folur. I veshur me një uniformë të hirtë të errët, jakën e shtrënguar pas fytit, i zbehtë, i dobët, me sytë e futur thellë, hundën e madhe dhe të zymtë, gojën si përbuzëse dhe flokët si qimet e furçës, të jepte në fillim përshtypjen e një rreptësie gati të skajshme. Por, në vështrimin e dytë, siç e vuri re Marçeloja viheshin re ca tipare që s'kishin asgjë të rreptë, përkundrazi: vështrimi i ankthshëm, i zjarrtë i syve; diçka të butë dhe si të lëshuar te buzët; pasiguria e përgjithshme e qëndrimit. Ai u përkul, mblodhi librat që Marçeloja kishte hedhur përtokë, duke u përpëlitur, e ia dha duke i thënë:

- Po ç'donin të të bënin?

Kishte një zë, edhe ai i rreptë si fytyra, por njëkohësisht jo pa një ëmbëlsi të mbytur. Marçeloja iu përgjigj i acaruar:

- Tallen gjithmonë me mua... Janë budallenj të vërtetë. Ndërkaq mendohej ta zgjidhte rripin e fundit në shpinë.

- Prit, - tha burri, duke u përkulur dhe duke e zgjidhur nyjën.

Fundi ra në tokë dhe Marçeloja doli prej tij duke e shkelur dhe mandej duke e hedhur me një shqelm mbi grumbullin e gjetheve të vdekura. Burri pyeti me njëfarë ndrojtjeje:

- A s'po shkoje në shtëpinë tënde?

- Po, - iu përgjigj Marçeloja duke ngritur sytë drejt tij.

- E pra, - tha burri, - po të çoj unë aty me makinë, - dhe tregoi, në një largësi jo aq të madhe, një automobil

të ndalur pranë trotuarit. Marçeloja e vështroi: ishte një makinë e një lloji që ai s'e njohte, mbase e huaj, e gjatë, e zezë, me formë të dalë mode. Çuditërisht, i erdhi mendimi se ajo makinë e ndalur ca hapa larg tyre, tregonte një paramendim në afrimin si të rastësishëm të burrit. Ngurroi para se të përgjigjej; burri këmbënguli:

- Hajde, pra... para se të të çoj në shtëpi do të bëj një xhiro të bukur... a të pëlqen?

Marçeloja do të donte të refuzonte ose më mirë e ndiente se duhet ta bënte. Po s'pati kohë: burri ia kishte hequr nga dora pakon e librave duke i thënë: - Ta mbaj unë, - dhe po shkonte drejt automobilit. E ndoqi pas, disi i çuditur për bindjen e vet, por jo i pakënaqur. Burri hapi derën, e bëri Marçelon të ulej pranë tij dhe hodhi librat në ndenjësen e pasme. Pastaj u ul në timon, mbylli derën, veshi dorëzat dhe e vuri në lëvizje makinën.

Automobili nisi të ecte pa nxitim gjatë shëtitorës së gjatë me pemë, në mënyrë madhështore dhe me një gumëzhimë të mbytur. Ishte tamam një makinë e tipit të vjetër, siç mendoi Marçeloja, por e mbajtur në rregull, e pastruar me dashuri, me tërë veglat prej tunxhi dhe nikelimet që shkëlqenin. Tani burri, ndonëse e mbante me një dorë timonin, me dorën tjetër kishte marrë një kasketë dhe e rregullonte në kokë. Kasketa ia shtonte pamjen e rreptë, i jepte gati një pamje ushtarake. Marçeloja pyeti me ndrojtje:

- Është juaja makina?

- Follmë me ti, - tha burri pa u kthyer dhe duke shtypur me dorën e djathtë borinë me tingull të rreptë dhe të vjetruar si makina.

- S'është imja... Është e atij që më paguan... Jam shoferi.

Marçeloja s'tha asgjë. Burri, duke ndenjur gjithnjë në profil dhe, duke vazhduar ta ngiste makinën me një saktësi të ftohtë dhe elegante, shtoi:

- Mos të vjen gjë keq që s'jam padroni? Të vjen turp?

Marçeloja protestoi me gjallëri:

- Jo, pse?

Burri pati një buzëqeshje të lehtë kënaqësie dhe e rriti shpejtësinë e ecjes.

- Tani le të shkojmë pak në kodër, - i tha, - mbi Malin Mario, a të pëlqen?

- S'kam qenë kurrë aty, - iu përgjigj Marçeloja.

- Është bukur, - tha burri, shihet gjithë qyteti... Heshti një çast, pastaj shtoi me ëmbëlsi: - Si quhesh?

- Marçelo.

- Po, është e vërtetë, - tha burri si duke folur me vete, - të thërrisnin Marçelina ata shokët e tu... unë quhem Paskuale.

Marçeloja s'pati kohë të mendonte se "Paskuale" ishte një emër qesharak kur burri si ta kishte marrë me mend me intuitë mendimin e tij, shtoi:

- Po është një emër qesharak... ti më thirr Lino.

Tani makina përshkonte rrugët e gjera dhe të pista të një lagjeje popullore, midis shtëpive të mjera. Grupe fëmijësh që luanin në mes të asfaltit shtyheshin mënjanë me nxitim, gra flokëshprishura, burra me rroba të grisura shihnin nga trotuari kalimin e pazakonshëm. Marçeloja uli sytë, duke i ardhur turp nga ajo kureshtje.

- Është Trionfalja, - tha burri, - po ja ku është Mali Mario. Makina doli nga *Lagja Popullore*, u fut në një rrugë të gjatë me spirale, prapa një tramvaji, në mes të dy radhëve me shtëpi të radhitura në të përpjetë.

- Në ç'orë duhet të jesh në shtëpi?

- Ka kohë, - tha Marçeloja, - s'hamë kurrë bukë para orës dy.

- Kush të pret në shtëpi? Babai dhe mamaja?

- Po.

- Ke edhe vëllezër?

- Jo.

- Dhe ç'bën babai yt?

- S'bën asgjë, - u përgjigj Marçeloja disi i pasigurt.

Makina e parakaloi tramvajin në një kthesë, dhe burri, për ta marrë kthesën sa më të ngushtë që të ishte e mundur, rëndoi me krahë mbi timon, por pa lëvizur trupin, me një shkathtësi plot elegancë. Pastaj makina, përherë në ngjitje, nisi të vraponte gjatë mureve të larta me bar, me kangjella vilash, me gardhe me shtog.

Herë pas here, një hyrje e stolisur me llamba veneciane apo një hark me tabelë ngjyrë gjaku kau tregonte praninë e ndonjë restoranti, të ndonjë pijetoreje të thjeshtë. Linoja pyeti papritur:

- A të bëjnë dhurata babai yt dhe mamaja jote?

- Po, - u përgjigj Marçeloja në mënyrë disi të vagullt, - nganjëherë.

- Shumë a pak?

Marçeloja s'deshi ta pranonte që dhuratat ishin pak dhe madje, në ndonjë rast, festat kalonin edhe pa dhurata. U mjaftua duke u përgjigjur:

- Ashtu, ashtu.

- A të pëlqen të marrësh dhurata? - e pyeti Linoja duke hapur një derëz të vogël të kroskotos, duke hequr prej andej një copë të vogël stofë të verdhë dhe duke pastruar xhamin. Marçeloja e vështroi. Burri rrinte gjithnjë në profil, me bustin drejt, kasketën mbi sy.

- Po, më pëlqen.

- Dhe çfarë dhurate do të të pëlqente të merrje, bie fjala?

Kësaj radhe fraza ishte fare e qartë dhe Marçeloja s'ndenji dot pa menduar që ky Linoja enigmatik, për ndonjë shkak të vetin, donte vërtet t'i bënte një dhuratë. Iu kujtua papritur tërheqja që ushtronin mbi të armët dhe njëkohësisht, gati me ndjesinë e një zbulimi, i tha vetes se zotërimi i një arme të vërtetë do t'i siguronte konsideratën dhe respektin e shokëve. Guxoi të thoshte në mënyrë disi skeptike, i vetëdijshëm se donte të fitonte kohë:

- Bie fjala, një revole...

- Një revole, - përsëriti burri pa treguar kurrfarë habie. - Çfarë revoleje? Një revole me fishekë apo një revole me ajër?

- Jo, - tha Marçeloja me guxim, - një revole të vërtetë.

- Dhe ç'do ta bëje një revole të vërtetë?

Marçeloja parapëlqeu të mos e thoshte arsyen e vërtetë.

- Do të shtija, - u përgjigj, - derisa të arrija në një shenjë të pagabueshme. Po pse e kërkon patjetër të kesh një shenjë të pagabueshme?

Burri dukej se i formulonte pyetjet, mendonte Marçeloja, më tepër nga dëshira ta bënte të fliste, sesa për kureshtje të vërtetë. Megjithatë iu përgjigj seriozisht:

- Me një shenjë të sigurt mund të mbrohesh kundër kujtdo.

Burri heshti për një çast. Pastaj sugjeroi:

- Vërë dorën në atë trastën aty në derën pranë teje.

Marçeloja, kureshtar, u bind dhe ndjeu nën gishtërinjtë e tij të ftohtin e një sendi prej metali.

- Nxirre po të duash, - tha burri. Automobili bëri një hedhje të shpejtë mënjanë për të shmangur një qen që po hidhej nga ana tjetër e rrugës. Marçeloja e nxori sendin prej metali, që ishte tamam revole automatike, e zezë dhe e sheshtë, e rënduar nga shkatërrimi dhe vdekja, me tytën e dalë përpara si për të pështyrë plumbat. Gati pa dashur, me gishtërinjtë që i dridheshin nga kënaqësia, ai shtrëngoi në grusht dorezën.

- Një revole si ajo? - pyeti Linoja.

- Po, - tha Marçeloja.

- Mirë, pra, - tha Linoja, - po e deshe vërtet, do të ta jap... veç jo atë, se i përket makinës... një tjetër si ajo.

Marçeloja nuk foli. I dukej se ishte futur në një atmosferë magjike përrallash, në një botë të ndryshme nga ajo e zakonshmja, në të cilën shoferë të panjohur të ftonin të hipje në makinë dhe të falnin revole. Gjithçka dukej se ishte bërë fare e lehtë, por njëkohësisht s'e dinte as vetë pse i dukej se ajo lehtësi aq e këndshme shfaqte në një çast të dytë një shije jo të mirë, sikur lidhur me të do të fshihej një vështirësi ende e panjohur, por e afërt dhe që do të zbulohej shpejt. Sipas të gjitha gjasave, mendoi

ai me gjakftohtësi, në makinë ishin dy veta që kishin një qëllim: qëllimi i tij ishte të zotëronte një revole, ndërsa ai i Linos ishte të merrte në shkëmbim të revoles diçka ende të mistershme dhe mbase të papranueshme. Tani ishte fjala për të parë se kush do të kishte përparësinë më të madhe nga këmbimi.

- Po ku po shkojmë? - pyeti ai.

- Shkojmë në shtëpinë ku banoj unë për të kërkuar revolen, - u përgjigj Linoja.

- Po ku është shtëpia?

- Ja, kemi arritur, - u përgjigj burri duke ia hequr nga dora revolen dhe duke e futur në xhep.

Marçeloja e vështroi: makina kishte ndalur në rrugën që tani ngjante tamam si rrugë fshati me pemët, gardhet prej shtogu, dhe, prapa gardheve, fushat dhe qielli. Por pak më poshtë dukej një portal me një hark, dy shtylla dhe kangjella të ngjyera me të gjelbër.

- Prit këtu, - tha Linoja. Ai zbriti dhe vajti te portali. Marçeloja e vështroi ndërsa hapte dy kanatat e kangjellave dhe mandej u kthye prapa: s'ishte i gjatë, ndonëse dukej i tillë kur ishte ulur; i kishte këmbët e shkurtra në krahasim me trungun dhe ijët e gjera. Linoja u ngjit përsëri në makinë dhe e ngau deri te portali. U duk një rrugicë me zall midis dy radhëve qiparisash të shpupluar që era e stuhishme i shkundte dhe i mundonte. Në fund të rrugicës, nën një rreze të dobët dielli, diçka shkëlqeu me mprehtësi në sfondin e qiellit të stuhishëm: një vetratë verande, të ndërftuar në një ndërtesë me vetëm dy kate.

- Është vila, - tha Linoja, - po s'ka njeri.

- Kush është i zoti? - pyeti Marçeloja.

- Do të thuash e zonja, - e korigjoi Linoja, - një zonjë amerikane, por është jashtë, në Firenze.

Makina u ndal në shesh. Vila, e gjatë dhe e ulët, me sipërfaqe drejtkëndëshe prej çimentoje të bardhë dhe tullash të kuqe që ndërthurej aty-këtu me vijat prej xhami pasqyrues të dritareve, kishte një portik të mbështetur në shtylla katrore, prej guri të palatuar. Linoja hapi derën e makinës dhe u hodh në tokë duke thënë:

- Të zbresim, pra.

Marçeloja s'e dinte se ç'donte Linoja prej tij dhe as nuk e gjente dot. Por gjithnjë e më tepër rritej tek ai mosbesimi tamam si ai që ka frikë se mos e gënjejnë.

- Po revolja? - pyeti pa lëvizur.

- Është aty brenda, - u përgjigj Linoja me njëfarë padurimi, duke treguar dritaret e vilës, - tani po shkojmë ta marrim.

- Do të ma japësh?

- Sigurisht, një revole të bukur, të re.

Pa thënë asnjë fjalë, Marçeloja zbriti, edhe ai. Menjëherë e sulmoi me një goditje të ngrohtë e tërë pluhur, era dehëse dhe e përmortshme e vjeshtës. S'e dinte as ai se pse, në atë goditje, provoi si një parandjenjë dhe, ndonëse ndiqte Linon, u kthye për të parë për herë të fundit sheshin me zall, të rrethuar me kaçube dhe landra të pazhvilluara. Linoja ecte para tij dhe ai vuri re se diçka ia frynte xhepin anësor të tunikës: revolja që burri, kur mbërritën aty, ia kishte hequr nga dora në makinë. Papritur e ndjeu veten të sigurt që Linoja s'kishte veçse atë revole dhe e pyeti veten pse vallë e

kish gënijer dhe tani e tërhiqte brenda vilës. Tek ai rritej ndjesia e mashtrimit dhe njëkohësisht vullneti për t'i mbajtur sytë të hapur dhe për të mos e lënë veten ta gënjenin. Ndërkaq ishin futur në një sallë të madhe ndenjje me grupe kolltukësh dhe divanesh, me një oxhak me kubënë prej tullash të kuqe në paretin e fundit. Linoja, gjithnjë duke ecur para Marçelos, u drejtua, përmes sallës, drejt një porte të lyster me të kaltër, në një qoshe.

- Po ku po shkojmë? - pyeti Marçeloja i shqetësuar.

- Shkojmë në dhomën time, - u përgjigj Linoja me zë të lehtë, pa kthyer kokën.

Marçeloja vendosi që të bënte në çdo rast një qëndresë fillestare, në mënyrë që Linoja ta merrte vesh që ai e kishte kuptuar lojën e tij. Pasi Linoja hapi derën e kaltër, ai tha, duke qëndruar larg:

- Ma jep revolen menjëherë, ndryshe po iki.

- Po s'e kam këtu revolen, - u përgjigj Linoja duke u kthyer përgjysmë. E kam në dhomën time.

- Sigurisht që e ke, - tha Marçeloja, - e ke në xhepin e xhaketës.

- Po kjo është e makinës.

- S'ke të tjera.

Linoja dukej se bëri një lëvizje padurimi që e ndërpreu menjëherë. Marçeloja vuri re edhe një herë kontrastin që formonin, me fytyrën e thatë dhe të rreptë, goja disi e butë dhe sytë e anktshëm, plot dhimbje, lutës.

- Do të ta jap këtë, - tha më në fund, - po hajde me mua... ç'rëndësi ka për ty? Këtu mund të na shohë ndonjë fshatar, me gjithë këto dritare...

“Ç’të keqe ka sikur të na shohin?”, do të kishte dashur të pyeste Marçeloja; por e përmbajti veten se e ndiente në mënyrë të errët që një e keqe ekzistonte, ndonëse e kishte të pamundur ta përkufizonte.

- Mirë, - tha në mënyrë naive, - po pastaj do të ma japësh?

- Rri i qetë.

U futën në një korridor të vogël të bardhë dhe Linoja mbylli derën. Në fund të korridorit kishte një derë tjetër të kaltër. Kësaj radhe Linoja nuk eci para Marçelos, por iu vu në anë dhe kaloi lehtëazi një krah rreth belit të tij, duke e pyetur:

- E do aq shumë revolen tënde?

- Po, - tha Marçeloja që s’fliste dot për sikletin që i jepte ai krah.

Linoja e hoqi krahun, e hapi derën dhe e futi Marçelon në dhomë. Ishte një dhomë e bardhë, e gjatë dhe e ngushtë, me një dritare në fund. Aty s’kishte veçse një krevat, një tavolinë, një dollap dhe nja dy karrige. Të gjitha këto mobilie ishin lyer me ngjyrë jeshile të hapur. Marçeloja vuri re të varur në mur, mbi krevat, një kryq bronzi të llojit më të zakonshëm. Mbi komodinë shihej një libër i trashë, me lidhje të zezë, me prerje të kuqe, që Marçelos iu duk si një libër lutjesh.

Dhoma ku s’kishte as sende, as rroba, ngjante tepër e pastër; megjithatë, në ajër kishte një aromë të fortë si prej sapuni me kolonjë.

Ku e kishte ndier herë tjetër? Mbase në banjë pasi ishte larë e ëma në mëngjes. Linoja i tha si me indiferentizëm:

- Ulu mbi krevat, a të pëlqen? Është diçka më e rehatshme. Dhe ai u bind në heshtje. Linoja tani vente

e vinte nëpër dhomë. Hoqi kasketën dhe e vuri mbi pezulin e dritares; zbërtheu jakën dhe me një shami fshiu djersën rreth qafës. Pastaj hapi dollapin, nxori prej tij një shishe të madhe me kolonjë, lagu aty shaminë dhe e kaloi me lehtësim mbi fytyrë e ballë.

- A e do edhe ti? - pyeti Marçelon. - Është freskuese.

Marçeloja do të donte të refuzonte, shishja dhe shamia i ngjallnin njëfarë neverie. Po e la Linon që t'i kalonte me një përkëdhelje të freskët, pëllëmbën e dorës mbi fytyrë. Linoja e vuri kolonjën prapë në dollap dhe erdhi të ulej në krevat, pranë Marçelos. Vështruan njëri-tjetrin. Fytyra e Linos, e thatë dhe e rreptë, tani kishte marrë një shprehje të re, të dëshpëruar, përkëdhelëse, lutëse. Ai e sodiste Marçelon dhe heshte.

Marçeloja, ngaqë e kishte humbur durimin dhe, gjithashtu, që t'i jepte fund asaj soditjeje që e vinte në siklet, pyeti më në fund:

- Po revolja?

E pa Linon të psherëtinte dhe mandej ta hiqte nga xhepi, si me gjysmë zemre, armën. Ai zgjati dorën, po fytyra e Linos u ashpërsua, ai e tërhoqi sendin dhe tha me nxitim:

- Do të ta jap... po ti duhet ta meritosh. Marçeloja, tek dëgjoji këto fjalë, ndjeu pothuajse një lehtësim. Pra, ai kishte menduar saktë. Linoja donte diçka në këmbim të revoles. Me një ton të kujdesshëm dhe me naivitet të shtirur si në shkollë, kur këmbente majat e penave apo topthat prej xhami tha:

- Ma thuaj ti ç'është si këmbim dhe të biem dakord.

E pa Linon të ulte sytë, të ngurronte, dhe mandej të pyeste ngadalë:

- Çfarë do të bëje për ta pasur këtë revole?

Ai vuri re se Linoja s'e kishte pranuar propozimin e tij: pra, s'ishte fjala për një send për ta këmbyer revolen, po për diçka që ai duhet të bënte për ta pasur. Megjithëse s'e kuptonte se ç'mund të ishte, tha gjithnjë, me atë tonin e shtirur naiv: - S'e di, ma thuaj ti. Pati një çast heshtjeje. - Do të bëje çdo gjë? - pyeti papritur Linoja me zë më të lartë, duke ia hapur dorën.

Toni dhe gjesti e alarmuan Marçelon. Ai pyeti veten mos vallë Linoja ishte një hajdut që i kërkonte bashkëfajësi. Pasi u mendua arriti në përfundimin se mund ta linte mënjane këtë hipotezë. Megjithatë u përgjigj me maturi:

- Po ç'do që të bëj? Pse s'e thua?

Linoja luante tani me dorën e tij duke e vështruar, duke e kthyer, duke e shtrënguar dhe duke ngadalësuar shtrëngimin. Pastaj, me një gjest gati të pasjellshëm, e shtyu dhe tha, duke e vështruar ngadalë:

- Jam i sigurt se ca gjëra s'do t'i bëje.

- Po thuaje, - këmbënguli Marçeloja me njëfarë vullneti të mirë të përzier me siklet.

- Jo, jo, - protestoi Linoja.

Marçeloja vuri re se një i kuq i çuditshëm, i pabarabartë, ia njolloste mbi faqe fytyrën e zbehtë. Iu duk se Linoja tundohej të fliste, por donte të sigurohej që ai e dëshironte këtë gjë. Atëherë pati një gjest kokoterie të vetëdijshme, ndonëse të pafajshme. U zgjat dhe kapi dorën e burrit:

- Thuaje, pra, pse nuk e thua?

Pasoi një heshtje e gjatë. Linoja shikonte, herë dorën e Marçelos, herë fytyrën e tij dhe dukej se ngurronte. Më në fund e shtyu përsëri dorën e djalit, po kësaj radhe me ëmbëlsi, u ndal dhe bëri ndonjë hap nëpër dhomë.

Pastaj u ul prapë dhe e mori përsëri dorën e Marçelos, në mënyrë të dashur, pak a shumë si një baba apo një nënë që ia marrin dorën të birit.

- Marçelo, - tha, - a e di kush jam unë?

- Jo.

- Jam një prift i çpriftëruar, - tha Linoja me një shpërthim zëri të dhimbshëm, të trishtuar, patetik, - një prift i çpriftëruar që e hoqën nga kolegji ku jepte mësim për sjellje të padenja... dhe ti, me pafajësinë tënde s'e merr me mend se ç'mund të të kërkoj në këmbim të kësaj revoleje që e lakmon aq shumë... dhe unë jam tunduar të përfitoj nga padituria jote, nga pafajësia jote, nga lakmia jote fëmijërore! Ja kush jam, Marçelo. Ai fliste me tonin e një sinqeriteti të plotë; mandej u kthye nga koka e krevatit dhe, në mënyrë të papritur, iu drejtua kryqit pa ngritur zërin, si duke u ankuar:

- Të jam lutur aq shumë... por ti më ke braktisur... dhe kjo ndodh gjithmonë e gjithmonë... Pse më ke braktisur?

Këto fjalë humbën në njëfarë murmuritje sikur Linoja t'i kishte folur vetes. Pastaj u ngrit nga krevati, mori kasketën që kishte vënë në pezulin e dritares dhe i tha Marçelos:

- Hajt të shkojmë... hajde të shoqëroj deri në shtëpi.

Marçeloja s'tha asgjë: e ndiente veten të shushatur dhe të paaftë në ato çaste të gjykonte ç'kishte ngjarë.

E ndoqi Linon nëpër korridor dhe mandej në sallën e ndenjjes. Jashtë në shesh era vazhdonte të frynte ende rreth makinës së madhe të zezë, nën një qiell me re dhe pa diell. Linoja hipi në makinë dhe ai iu ul pranë. Makina lëvizti, përshkoi rrugicën, doli butësisht nga portali, në rrugë. Për një çast të gjatë nuk folën. Linoja e ngiste makinën si më parë, duke e mbajtur trungun drejt, me kasketën mbi sy, me duart me dorashka të mbështetura në timon. Përshkruan një copë të mirë rruge dhe mandej Linoja, pa kthyer kokën, pyeti papritur:

- Të vjen keq që s'e more revolen?

Në këto fjalë, në shpirtin e Marçelos u rindez shpresa e zjarrtë për ta zotëruar sendin aq të lakmuar. "Në fund të fundit", mendoj, "mbase s'kishte humbur ende asgjë".

- Sigurisht që më ka ardhur keq, - u përgjigj me sinqeritet.

- Kështu, - pyeti Linoja, - po të të lija takim për nesër në të njëjtën orë si sot... ti do të vije?

- Nesër është e diel, - u përgjigj në mënyrë të arsyeshme Marçeloja, - po të hënën po... mund të takohemi në rrugë në të njëjtën orë si sot.

Lino heshti një çast. Mandej papritur, me një zë ankues dhe të fortë, thirri:

- Mos më fol më... mos më shiko më... dhe po të më shohësh të hënën në mesditë në rrugë, mos pyet për mua, mos më përshëndet... e kuptove?

"Po ç'e zuri kështu?", e pyeti veten Marçeloja disi i inatosur. Dhe u përgjigj:

- Mua s'më mori malli të të shoh... ishe ti që më more sot në shtëpinë tënde.

- Po, por s'duhet të përsëritet më... kurrë më, - tha Linoja me zjarr, - e njoh veten dhe e di me siguri që sonte natën s'do të bëj gjë tjetër veçse të mendoj për ty... dhe që të hënën do të të pres në rrugë edhe po qe se sot vendos të mos e bëj... e njoh veten... por ti s'duhet të pyesësh për mua.

Marçeloja s'foli. Linoja vazhdoi, përherë me atë furi:

- Unë do të mendoj për ty tërë natën, Marçelo... dhe të hënën do të jem në rrugë... me revolen... por ti s'duhet të pyesësh për mua. Ai vërtitej rreth së njëjtës frazë, duke e përsëritur, dhe Marçeloja me kuptueshmërinë e tij të ftohtë dhe të pafajshme, e kuptonte se në të vërtetë Linoja donte t'i caktonte një takim dhe me pretekstin që po e këshillonte të ruhej, në fakt ia caktonte. Linoja, pas një çasti heshtjeje, pyeti përsëri:

- E dëgjove?

- Po.

- Çfarë thashë?

- Se të hënën do të më presësh në rrugë.

- S'të thashë vetëm këtë, - tha Lino me dhimbje.

- Dhe se, - përfundoi Marçeloja, - unë s'duhet të pyes për ty.

- Po, - këmbënguli Linoja, - me asnjë kusht... Shiko, se unë do të të thërras, do të të lutem, do të të ndjek nga prapa me makinë... do të të premtoj gjithçka që të duash... por ti duhet të ecësh përpara dhe të mos shqetësohesh për mua.

Marçeloja, që e kishte humbur durimin, u përgjigj:

- Mirë, e kuptova.

- Po ti je një fëmijë, - tha Linoja, duke kaluar nga furia në njëfarë ëmbëlsie përkëdhelëse, - dhe s'do të më rezistosh dot... Do të vish, pa dyshim... Je një fëmijë, Marçelo. Marçeloja u fye dhe shtoi:

- S'jam një fëmijë... jam një djalë... E pastaj ti s'më njeh.

Linoja e ndali befas makinën. Ishin ende në rrugën e kodrës, nën një mur të lartë rrethues, më tutje vihej re harku i stolisur me llamba ngjyra-ngjyra të një restoranti.

Linoja u kthye nga Marçeloja.

- Vërtet, - pyeti me një lloj ankthi të dhimbshëm, - vërtet s'do të pranosh të vish me mua?

- A s'je tamam ti, - pyeti Marçeloja tashmë i vetëdijshëm për lojën e tij, - që po ma kërkon?

- Po, është e vërtetë, - tha Linoja i dëshpëruar, duke e vënë prapë makinën në lëvizje, - po, është e vërtetë... ke të drejtë... jam unë i çmenduri që po ta kërkoj... tamam unë.

Pas kësaj thirrjeje ai nuk foli dhe ra heshtja. Makina zbriti deri në fund të rrugës dhe përshkoi përsëri rrugët e pista të *Lagjes Popullore*. Ja rruga e madhe me rrapet e gjata të zhveshura dhe të bardha, grumbujt me gjethe të verdha gjatë trotuareve të shkreta, fabrikat plot dritare. Ja lagjja ku gjendej vila e Marçelos. Linoja, pa kthyer kokën pyeti:

- Ku e ke shtëpinë?

- Është më mirë që të ndalosh këtu, - tha Marçeloja, i vetëdijshëm për kënaqësinë që i frymëzonte burrit ai theks bashkëfajësie i tij, - përndryshe mund të më shikojnë ndërsa zbres nga makina jote. Makina u ndal. Marçeloja zbriti dhe Linoja, përmes dritares së vogël, i zgjati pakon e librave, duke thënë me vendosmëri:

- Atëherë të hënën, në rrugë, në të njëjtin vend që ishim sot.

- Por unë, - tha Marçeloja duke marrë librat, - duhet të bëj sikur s'të shoh, apo jo?

E pa Linon tek ngurronte dhe provoi gati një ndjenjë kënaqësie mizore. Sytë e Linos, të ndezur fuqishëm, në fund të gropave të futura thellë, e panë tani me një vështrim lutës dhe të ankthshëm. Mandej ai tha me pasion:

- Bëj si të duash... bëj ç'të duash me mua. Zëri i tij përfundoi në njëfarë ankimi këngëzues e plot dëshirë.

- Kije parasysh se unë s'do të t'i hedh as sytë, - e paralajmëroi Marçeloja për herë të fundit.

E pa Linon tek bënte një gjest që ai s'e kuptoi, por iu duk si pranim i dëshpëruar. Pastaj makina u nis, duke u larguar ngadalë drejt rrugës.

III

Çdo mëngjes Marçelon e zgjonte, në një orë të caktuar, gjellëbërësja që e donte në mënyrë të veçantë. Ajo hynte në errësirën e dhomës duke sjellë tabakanë e mëngjesit që e mbështeste në mermerin e komosë dhe, mandej, Marçeloja e shihte tek varej me të dyja krahët te litari i kanatave dhe e tërhiqte me nja dy a tri të shtyra të shtatit të saj të fuqishëm. Ajo ia vinte tabakanë mbi gjunjë dhe e vëzhgonte në këmbë teksa hante mëngjesin, e gatshme që kur të përfundonte ai, t'ia hiqte batanijen dhe ta nxiste të vishej. Ajo vetë e ndihmonte duke ia dhënë rrobat, nganjëherë duke u gjunjëzuar për t'ia mbathur këpucët. Ishte një grua e gjallë, e gëzuar dhe plot gjykim të shëndoshë; ruante nga provinca ku kishte lindur theksin dhe zakonet e dashura. Të hënën, Marçeloja u zgjua me kujtimin e turbullt se kishte dëgjuar një mbrëmje më parë, kur po e zinte gjumi, një shpërthim zërash të zemëruar, që s'i kujtohej mirë nga vinin a në katin përdhes a në dhomën e prindërve. Priti sa hëngri mëngjesin dhe pastaj pyeti

rastësisht gjellëbërësen që, si zakonisht, priste në këmbë që ai të kishte përfunduar.

- Ç'ngjau sonte?

Gruaja e vështroi me një habi të shtirë e të ekzagjeruar:

- Me sa di unë, asgjë.

Marçeloja e kuptoi se ajo diç kishte për të thënë: habia e shtirë, shkëlqimi i djallëzuar i syve, si dhe tërë qëndrimi i saj, e tregonin.

- Dëgjova që thërrisnin... - tha ai.

- Ah, britmat, - tha gruaja, - po kjo është normale, a s'e dije se babai yt dhe mamaja jote bërtasin shpesh?

- Po, - tha Marçeloja, - por bërtisnin më fort se zakonisht.

Ajo buzëqeshi dhe, duke u mbështetur me të dyja duart te shpina e krevatit, tha:

- Të paktën, duke thirrur, do të jenë kuptuar më mirë, apo jo?

Ishte një nga ojnmat e saj: të bënte pyetje që nuk prisnin përgjigje pohuese.

- Po pse bërtisnin? - pyeti Marçeloja.

Gruaja buzëqeshi përsëri:

- Pse bërtasin njerëzit? Se nuk shkojnë mirë.

- Dhe pse nuk shkojnë mirë?

- Ata? - thirri ajo e lumtur për këto pyetje të djalit. - Oh, për një mijë arsye... mbase një ditë mamaja jote do të donte të flinte me dritare hapur dhe babai yt nuk do donte... një ditë tjetër atij i pëlqen të bjerë herët, kurse mamasë sate i pëlqen të vonohet... shkaqet s'mungojnë kurrë, apo jo?

Marçeloja, si për të shprehur një ndjenjë të tij të vjetër, tha papritur me seriozitet dhe bindje:

- Unë s'do të doja të rrija më këtu.

- Dhe çfarë do të doje të bëje? - pyeti gruaja, përherë edhe më e gëzuar. - Ti je i vogël, s'mund të ikësh nga shtëpia... duhet të presësh sa të rritesh.

- Do të parapëlqeja, - tha Marçeloja, - që të më fusnin në një kolegji.

Gruaja e vështrroi e mallëngjyer dhe thirri:

- Ke të drejtë... në një kolegji, të paktën, do të kishe dikë që të mendonte për ty... E di pse kanë bërëtitur aq shumë babait yt dhe mamaja jote?

- Jo, pse?

- Prit të ta tregoj. Ajo, plot zell, shkoi te dera dhe u zhduk. Marçeloja e pa të zbriste me vrap nëpër shkallë dhe e pyeti përsëri veten ç'mund të kishte ndodhur një natë më parë. Pas një çasti ndjeu gjellëbërësen tek ngjiste shkallët; mandej ajo u fut në dhomë me një pamje enigmatike e të gëzuar. Mbante në dorë një send që Marçeloja e njohu menjëherë: një fotografi të madhe, e bërë kur Marçeloja ishte pak më tepër se dy vjeç. Aty dukej mamaja e Marçelos, e veshur në të bardha, me të në dorë, dhe ai me një rrobë të shkurtër të bardhë e një kordele po të bardhë në flokët e gjatë.

- E sheh këtë fotografi, - thirri gjellëbërësja me gëzim, - mamaja jote mbrëmë, duke u kthyer nga teatri, u fut në sallon dhe gjëja e parë që pa mbi piano, ishte kjo fotografi... Së gjorës për pak s'i ra të fikët... Shiko një herë ç'i ka bërë kësaj fotografie babai yt.

Marçeloja e pa i çuditur fotografinë. Dikush me majën e një brisku apo të një fëndyelli ia kishte shpuar sytë si nënës, ashtu edhe djalit, dhe më vonë me lapsin e kuq kishte bërë shumë vijëza të kuqe nën sytë e të dyve si për të treguar lot gjaku që binin nga katër vrimat. Kjo gjë ishte aq e çuditshme dhe e papritur dhe, njëkohësisht, aq në mënyrë të errët kobzezë, sa Marçeloja për një çast s'diti ç'të mendonte.

- Këtë gjë e ka bërë yt atë, - thirri gjellëbërësja, - dhe mamaja jote kishte arsye të bërtiste.

- Po pse e ka bërë?

- Është një magji, e di se ç'është një magji?

- Jo.

- Kur ke inat dikë... bën atë që bëri babai yt... Ndonjëherë, në vend që të shposh sytë, shpon gjoksin... në drejtim të zemrës... mandej ndodh diçka.

- Çfarë?

- Njeriu vdes... apo i ndodh një fatkeqësi... varet.

- Po unë, - belbëzoi Marçeloja, - s'i kam bërë asgjë të keqe babait.

- Po mamaja jote atëherë, ç'i ka bërë? - thirri gjellëbërësja e indinjuar. - A e di se ç'është yt atë? I çmendur... dhe, a e di ku do të përfundojë? Në Shën Onofrio, në shtëpinë e të çmendurve... dhe tani vishu, ka ardhur ora të shkosh në shkollë... Unë po shkoj ta vë në vend këtë fotografi. Ajo iku me vrap plot gëzim dhe Marçeloja mbeti vetëm. I menduar, pa mundur të shpjegonte në asnjë mënyrë rastin e fotografisë, nisi sërish të vishet.

S'kishte provuar kurrë për të atin asnjë ndjenjë të veçantë dhe armiqësia e tij, e vërtetë a e shtirur të ishte, s'i

shkaktonte dhimbje; po fjalët e gjellëbërëses për pushtetin keqbërës të magjisë e bënin të mendohej. Jo se ishte besëtyt dhe besonte vërtet se mjaftonte t'i shpoje sytë një fotografie për t'i bërë keq njeriut të fotografuar; por kjo çmenduri e të atit zgjonte tek ai një shqetësim që kishte pasur iluzionin se e kishte vënë në gjumë përfundimisht. Ishte ndjesia e frikshme dhe e pafuqishme se ishte futur në rrethin e një fataliteti kobzi që e kishte munduar tërë verën dhe që tani, si një thirrje e një ndjenje keqbërëse, para asaj fotografie të njollosur me lot gjaku, zgjohej në shpirtin e tij më e fortë se kurrë.

“Ç’ishte fatkeqësia?”, e pyeti veten. “Ç’ishte në mos një pikë e zezë e humbur në kaltërsinë e qiejve më të qetë që papritur rritet, bëhet një zog grabitqar i pashpirt dhe i bie përsipër fatkeqit si një skifter mbi kufomë? Apo gracka për të cilën të kanë paralajmëruar dhe, madje, e sheh qartë, por, megjithatë, nuk mund të mos e fusësh këmbën? Apo, madje, një mallkim ngathtësie, pamaturie dhe verbërie të futur në gjeste, në ndjesi, në gjak?” Ky përkufizim i fundit iu duk më i përshtatshëm, si ai që lidhte fatkeqësinë me një mungesë hijeshie dhe mungesën e hijeshisë me një fatalitet të brendshëm, të errët, të papërshkueshëm, tek i cili, gjesti i të atit, si një tabelë në fillimin e një rruge kobzezë, kishte tërhequr përsëri vëmendjen e tij. Ai e dinte se ky fatalitet kërkonte që ai të vriste; po ajo që e trembte më shumë nuk ishte vrasja, por paracaktimi i kësaj vrasjeje, çfarëdo që të bënte ai.

E trembte, pra, ideja se edhe vetëdija ishte padituri; por një padituri të një lloji të veçantë që askush s’mund ta quante të tillë dhe ai, më pak se të tjerët.